



Mbrojtja

Viti i 87-të i botimit
Nëntor 2019/ Nr. 11



Takimi

**Stoltenberg: Shqipëria
tregon përkushtim të
fortë ndaj Aleancës**



**Misioni i NATO-s, "Sea Guardian"
Kontingjenti XIII
kthehet nga misioni
në detin Egje**



ALB-GRC 05

**"Naval Staff Talks"
Bashkëpunim midis Forcës
sonë Detare dhe Flotës greke**



**Rumani, Bukuresht, në datat 15-16 tetor 2019
Shqipëria drejton ministerialin e
Mbrojtjes të Europës Juglindore**

Përmbajtja

Numri 11

DITA E VIZITORËVE TË SHQAR"

- 10** Përfundon stërvitja rajonale "Joint Reaction 2019"

FORCA TOKËSORE

- 13** Batalioni i II i Këmbëorisë, stërvitje dislokuese në Gjirokastrë

MISIONI I NATO-S "AEGEAN SEA"

- 14** Forca Detare: Kontigjenti i 14-të nis drejt detit Egje

21-VJETORI I KRIJIMIT

- 32** Batalioni i Forcave Speciale strukturë e rëndësishme e FA

"LOJRA OLIMPIKE USHTARAKE BOTËRORE 2019"

- 34** Nëntetarja Luiza Gega në vendin e tretë, merr medaljen e bronzit

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Saimir ALIJA

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



4 RUMANI, BUKURESHT

Shqipëria drejton ministerialin e Mbrojtjes të Europës Juglindore

Në cilësinë e vendit që mban kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (South-East Europe Defence...



7 TAKIMI

Stoltenberg: Shqipëria tregon përkushtim të fortë ndaj Aleancës

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta zhvilloi me 28 tetor 2019, një vizitë zyrtare në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, në Bruksel, ku u prit nga Sekretari i Përgjithshëm...



18 ALB-GRC 05, "NAVAL STAFF TALKS"

Bashkëpunim midis Forcës sonë Detare dhe Flotës greke

Në zbatim të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh midis Forcës sonë Detare dhe flotës greke, në datat 21-23 tetor në Komandën...



44 HISTORI

Lufta për vilajetin e Janinës në katër epoka

Historia e luftimeve është romani më i përgjakshëm i njerëzimit, një romani pambarim për popujt që ka të shkruar në "faqet" e betejave fitues dhe humbës, triumfues dhe të mundur...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 87-të i botimit
Nr. 11/2019

© *Ministria e Mbrojtjes*

*Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfutimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





Rumani, Bukuresht, në datat 15-16 tetor 2019

Shqipëria drejton ministerialin e Mbrojtjes të Europës Juglindore

Në cilësinë e vendit që mban kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (South-East Europe Defence Ministerial-SEDM), Ministria e Mbrojtjes drejtoi Takimin e Ministrave të Mbrojtjes së SEDM, Ministerial, i cili u zhvillua në Bukuresht, Rumani, në datat 15-16 tetor 2019.

Me pjesëmarrjen e 16 vendeve anëtare, përfaqësues të lartë nga NATO si Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s për Diplomacinë Publike, Ambasadori Tacan Ildem si dhe nga organizata të tjera ndërkombëtare si UN dhe RACVIAC, takimi u drejtua nga zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM. Vendet antyare të SEDM, janë: Shqipëria, Bosnjë dhe Herce-

govina, Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Greqia, Italia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia dhe Ukraina. kurse Republika e Moldavisë është si vëzhgues.

Në fillim të këtij takimi z. Koçi prezantoi prioritetet, që do të ketë vendi ynë gjatë kryesimit të kësaj iniciative duke vënë theksin tek "Politika e dyerve të hapura" për çdo shtet tjetër në rajon dhe më



Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi prezantoi prioritetet, që do të ketë vendi ynë gjatë kryesimit të kësaj iniciative duke vënë theksin tek "Politika e dyerve të hapura" për çdo shtet tjetër në rajon dhe më gjerë, i cili aspiron të jetë pjesë e këtij forumi me fokusin kryesor promovimin e Sigurisë dhe Mbrojtjes. U rikonfirmua gjithashtu, si një nga prioritetet kryesore të Iniciativës angazhimi për forcimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit si dhe bashkëpunimi në kuadër të trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.



Ky ishte Ministeriali i parë i SEDM-it i drejtuar nga Shqipëria, gjatë kryesimit 2019-2021

gjerë, i cili aspiron të jetë pjesë e këtij forumi me fokusin kryesor promovimin e Sigurisë dhe Mbrojtjes. U rikonfirmua gjithashtu, si një nga prioritetet kryesore të Iniciativës angazhimi për forcimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit si dhe bashkëpunimi në kuadër të trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Politikë dhe Planifikim

të Mbrojtjes, të Malit të Zi, Ivica Ivanoviç, theksoi se "Mali i Zi është i përkushtuar për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, si një nga qëllimet kryesore të politikës së jashtme, i cili është thelbësor për përparimin e përgjithshëm të rajonit". Ai theksoi se "nisma SEDM është një platformë shumë e rëndësishme për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal në fusha të tilla

si forcimi i integritetit në sektorin e mbrojtjes, udhëheqja e grave në sektorin e sigurisë, ndërlidhja e spitaleve ushtarake dhe zhvillimi i një rrjeti simulues në vendet e Evropës Juglindore". Ai gjithashtu theksoi se "iniciativa është një platformë e shkëlqyeshme për të kanalizuar aspiratat euro-atlantike të vendeve të rajonit, të cilat janë garantuesit e paqes dhe sigurisë".

Gjatë takimit, ministrant e mbrojtjes të vendeve anëtare të procesit SEDM diskutuan edhe për statusin aktual në projektet e krijuara në kuadër të procesit SEDM, siç janë: Ndërlidhja e Spitaleve Ushtarake, Ndërtimi i Integritetit, Gratë Udhëheqëse në Mbrojtje dhe Siguri, Portali SEDM, etj.

Më tej, Ministeriali vijoi me qëndrimet e vendeve anëtare dhe fokusin që do të ketë kjo iniciative në të ardhmen, mbi angazhimin e përbashkët për promovimin e paqes dhe stabilitetit në Europën Juglindore. Vendet anëtare ranë dakord për të zhvilluar më tej bashkëpunimin në nivel politik dhe ndërqeveritar nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta të SEDM. Në këtë takim u miratuan disa dokumente, të cilat do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e projekteve dhe aktiviteteve të përbashkëta gjatë vitit të ardhshëm.

Takimi u mbyll me miratimin e Deklaratës së Përbashkët të Ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Evropës Juglindore. Ky ishte Ministeriali i parë i SEDM-it i drejtuar nga Shqipëria, gjatë kryesimit 2019-2021. Përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse në SEDM shprehën vlerësimin e tyre të mirë për drejtimin Sekretariatit të SEDM, nga Shqipëria si dhe vlerësimin e tyre më të thellë për ish-kryetarin e SEDM Ambasadori e greqisë Eleftherios ANGELOPOULOS dhe Sekretariatit e Athinës për kontributet e dhënë gjatë mandatit të tyre. Takimi shënon gjithashtu festimin e 20 vjetorit të aktivizimit të SEEBRIG, një platformë unike për bashkëpunim, trainim të ndërsjellë, shkëmbim të ideve dhe mësimëve të marra.

Në kuadër të Procesit të Planifikimit të Kapaciteteve të Mbrojtjes së NATO (NATO Defence Planning Process-NDPP), në vendin tonë, në mjediset e Garnizonit "Skënderbej", më datat 15-16 tetor 2019, u zhvillua takimi dypalësh Shqipëri-NATO mbi Pyetësonin e Planifikimit të Kapaciteteve të Mbrojtjes (DPCS) 2019.

Qëllimi i këtij Takimi ishte diskutimi rreth plotësimit të Pyetësonit të Kapaciteteve të Mbrojtjes së NATO (DPCS-2019), që Shqipëria ka dërguar në NATO. Gjithashtu, njohja me rezultatet e arritura nga vendi ynë në implementimin e Paketës së Objektivave të Kapaciteteve 2017, statusin aktual të politikave dhe planeve të mbrojtjes, si dhe progresin e Rishikimit të Kapaciteteve.

Takimi u hap nga drejtuesi i palës shqiptare z. Gjergji Methoxha, drejtor i Drejtorisë së Politikave NATO dhe BE në Ministrinë e Mbrojtjes. Pas fjalës së hapjes, u vijua me ndarjen në grupe pune sipas fushave të planifikimit. Diskutimet u zhvilluan sipas formatit të pyetjeve dhe paqartësive që stafi i NATO kishte dërguar më herët për palën tonë.

Në përgjithësi, takimi rezultoi i frytshëm dhe tepër informues, kjo e vlerësuar edhe nga vetë drejtuesi i delegacionit të NATO z. Paul Savereux, drejtor i Planifikimit të Mbrojtjes në Divizionin e Politikave dhe Planeve në Stafin Ndërkombëtar të NATO, në ditën e dytë të takimit gjatë diskutimit mbi përfundimet e takimit.

Ndër të tjera, nga drejtuesi i delegacionit të NATO u vlerësua mjaft pozitivisht; rritja dhe ruajtja e vullnetit politik për zhvillimin dhe implementimin e Paketës së Objektivave të Kapaciteteve 2017; trendi rritës në arritjen e zotimeve në kuadër të Buxhetit të Mbrojtjes në 2% në vitin 2024 dhe për Shpenzimet e Mëdha në 20% në vitin 2024; kontributet e gjera operacionale të Shqipërisë.

Takimi dypalësh Shqipëri-NATO

Planifikimi i Kapaciteteve të Mbrojtjes (DPCS) 2019



300 pozicione të lira në Forcat e Armatosura

Nëse keni dëshirë për tu bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, tashmë e keni një mundësi. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, përmes një postimi në profilin e tij në Facebook, njofton se 300 pozicione të lira pune ofrohen anembanë vendit, për çdo të ri me arsim të mesëm e sipër. "Për çdo të ri me vullnet që do t'i shërbejë atdheut dhe vetes, Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë vendi i duhur! Mbi 300 pozicione të lira pune ofrohen anembanë vendit, për çdo të ri me arsim të mesëm e sipër. Nëse ke një zanat eja shërbe në FA, nëse s'ke, eja përfitoje", shkruan ministria Xhaçka. Madje Qendra e Personel Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 09.03-15.05.2020, gjithsej 312 kandidatë si: ndërlidhje 17, Polici Ushtarakë 15, Këmbësori 120, MZ 2, shofer 47, mirëmbajtje 9, kuzhinier 2, motorist 2, xhenio 2, infermieri 11, roje 83, dhe muzikant 2. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është deri në 30 dhjetor 2019.



Kreu i shtetit në Bruksel, takim me Stoltenberg

Stoltenberg: Shqipëria tregon përkushtim të fortë ndaj Aleancës

“Interesimi i NATO-s përfshin një investim të madh në një bazë të re ajrore në Shqipëri, e cila tani është duke u zhvilluar”

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta zhvilloi me 28 tetor 2019, një vizitë zyrtare në Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s, në Bruksel, ku u prit nga Sekretari i Përgjithshëm, Sh.T.Z. Jens Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg përshëndeti Presidentin Ilir Meta për praninë e tij në selinë e NATO-s ku diskutuan lidhje me përgatitjet për takimin e Kryetarëve Aleate të Shteteve dhe Qeverive në Londër në muajin dhjetor 2019. Ata gjithashtu adresuan angazhimin e NATO-s për stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit Perëndimor. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg tha se Shqipëria ka qenë e përkushtuar dhe Aleate që nga anëtarësimi në NATO, 10 vjet më parë, duke kontribuar në grupin shumëkombësh të forcave të NATO-s në Letoni, misionin paqeruajtës të KFOR-it të NATO-s në Kosovë dhe Misionin e Mbështetjes Vendors në Afganistan. Z.

Stoltenberg gjithashtu theksoi angazhimin e Aleancës për Shqipërinë, siç dëshmohet nga investimi i NATO-s për të përmirësuar infrastrukturën në bazën ajrore të Kuçovë. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Shqipërinë që ishte një avokat i fortë për politikën e derës së hapur të NATO-s dhe luajti një rol kryesor në promovimin e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor. Pas takimit Sekretari i Përgjithshëm, Sh.T.Z. Jens Stoltenberg dhe Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta dhanë deklaratat dhe u përgjigjën pyetjeve të gazetarëve.

Jens Stoltenberg, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s:

Presidenti Meta, është mirë të të shoh përsëri. Është mirë të të shoh këtu në Selinë e re të NATO-s. Shqipëria ka qenë një anëtar i vendosur dhe i përkushtuar i NATO-s për 10 vjet. Dhe ju vazhdoni në misione dhe operacione të ndryshme



të NATO-s, për sigurinë tonë të përbashkët, në mënyra të ndryshme. Ju jeni duke luajtur një rol kryesor në paqeruajtjen tonë dhe misionin tonë në Kosovë, duke sjellë siguri më të madhe në Ballkanin Perëndimor. Ju jeni pjesë e misionit të Asistencës dhe Këshillimit që NATO ka në Afganistan për të ndihmuar në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe gjithashtu jeni pjesë e prezencës së shtuar ushtarake në rajonin e Balltikut, duke dërguar disa trupa dhe forca në grupin tonë të betejës në Letoni. Dhe e gjithë kjo tregon përkushtimin e fortë të Shqipërisë ndaj Aleancës sonë. Edhe NATO është e përkushtuar për Shqipërinë. Kjo përfshin një investim të madh në një bazë të re ajrore në Shqipëri, e cila tani është duke u zhvilluar. Përmirësimi i kësaj infrastrukture do të përmirësojë sigurinë e vendit tuaj. Vitin tjetër, Shqipëria do të marrë një rol të rëndësishëm në sigurinë ndërkombëtare kur do kryesoi OSBE-në. OSBE-ja është një forum i rëndësishëm, një platformë e rëndësishme, për të diskutuar kontrollin e armëve, transparencën ushtarake dhe masat e ndërtimit të besimit. Të gjithë Aleatët e NATO-s mbeten të përkushtuar për armët efektive, kontrollin, çarmatim dhe mos-përhapjen. Dhe ndërsa ne përpiqemi të adaptojmë regjimin e kontrollit të armëve me realitetet e reja, bashkëpunimi i NATO-s me OSBE-në është shumë i rëndësishëm.

Gjatë takimit tonë, ne diskutuam gjithashtu rëndësinë e ndarjes së barrës brenda Aleancës. Dhe unë mirëpres që Shqipëria ka filluar të investojë më shumë në mbrojtje dhe ka deklaruar angazhim për të arritur qëllimin për të shpenzuar 2% të PBB-së së mbrojtjes deri në vitin 2024. Ne diskutuam gjithashtu situatën në Ballkanin Perëndimor. Angazhimi i NATO-s për stabilitetin dhe sigurinë në atë rajon. Dhe falënderova Shqipërinë që luajti një rol kryesor në promovimin e bashkëpunimit në të gjithë rajonin. Ju e njihni rajonin dhe luani një rol të rëndësishëm për të ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit dhe paqes. Shqipëria është një

avokat i fortë për Portën e Hapur të NATO-s dhe integrimin e fqinjëve tuaj në familjen Euro-Atlantike. Shqipëria tashmë ka ratifikuar Protokollin e pranimit për Maqedoninë e Veriut. Ky proces është në rrugën e duhur nëpër kryeqytetet aleate. Dhe mezi pres që Maqedonia e Veriut të bashkohet së shpejti në NATO. Pra, edhe një herë, jeni i mirëpritur në Shtabin e NATO-s, për të vazhduar bashkëpunimin tonë të shkëlqyeshëm. Shume faleminderit.

Ilir Meta, President i Shqipërisë: Shumë faleminderit, Sekretar i Përgjithshëm. Ishte një kënaqësi e madhe të takoja ty dhe gjithashtu të kem një shkëmbim shumë të mirë të pikëpamjeve për çështje të rëndës-

sur për lidhjen tonë transatlantike. Unë kam qenë i kënaqur të vërej një njohje të merituar të pranisë së Shqipërisë në operacionet dhe misionet e NATO-s, përfshirë këtu në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ne jemi krenarë për gratë dhe burrat tanë që i shërbejnë paqes dhe lirive brenda dhe përtej kufijve të Aleancës.

Gjatë takimit, përmenda rëndësinë që i kushtojmë përzgjedhjes së bazës ajrore të Koçovë, siç nënvizuat edhe ju, për investime të mëtutjeshme të NATO-s, si një vlerë e shtuar, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin. Pranimi i ardhshëm i Maqedonisë Veriore është një tjetër arritje e rëndësishme



sishme. Këtë vit shënon 70 vjetori i Aleancës sonë dhe gjithashtu 10 vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë. Në shtatë dekada, NATO ka qëndruar në mënyrë të paparë si zona më e suksesshme e paqes dhe prosperitetit. Ne e kuptojmë shumë mirë se çfarë kërkon dhe do të thotë të jesh pjesë e një familje, e bazuar mbi parimet e sigurisë, lirive dhe demokracisë. Ne do ta respektojmë premtimin e investimeve në mbrojtje si një angazhim të vendo-

për tërë Ballkanin Perëndimor. Dy ditë më parë, unë u takova me Presidentin e Maqedonisë Veriore Pendarovski dhe të dy nënvizua se politika e NATO-s me dyer të hapura dhe zgjerimi drejt këtij rajoni vazhdon të jetë strategjik dhe instrumental për paqen dhe stabilitetin. Ende mbaj mend kur nënshkroi personalisht në 1 maj 2003 iniciativën amerikane Adriatic 3, me qëllim të përshpejtimit të procesit të pranimit të Shqipërisë, Kroacisë

dhe Maqedonisë së Veriut në NATO. Ne nuk mund të jemi krenarë që ky proces ka qenë i suksesshëm dhe i shtrirë edhe më tej në formatin [[të padëgjueshëm] i cili rastësisht kryesohet nga Shqipëria këtë vit.

Në diskutimin tim me sekretarin Stoltenberg gjithashtu inkurajova vazhdimësinë e misionit të NATO-s në Kosovë dhe forcën dhe praninë në mbështetje të institucioneve të sigurisë së Kosovës. E drejta legjitime e Kosovës për të shndërruar gradualisht forcat e sigurisë së Kosovës në ushtri të ndërveprueshme dhe multi-etnike të NATO-s, përmes procesit legal, transparent dhe demokratik, është një burim i forcës dhe sigurisë për rajonin. Inkurajoj rivendosjen e dialogut Kosovë-Serbi, duke synuar një marrëveshje përfundimtare, ligjërueshme, e cila është e qëndrueshme, e zbatueshme, njezh pavarësinë dhe sovranitetin e kthyeshëm të Kosovës, kontribuon në paqen dhe stabilitetin e rajonit dhe normalizon plotësisht marrëdhëniet midis dy vende. Ne patëm një diskutim shumë të gjerë mbi zhvillimet e fundit dhe ranë dakord plotësisht për rritjen e sfidave në mjedisin tonë të sigurisë. Kjo është arsyeja pse ne duhet të ruajmë kohezionin dhe unitetin. Ne duhet të bashkojmë të gjitha përpjekjet strategjike për të mbajtur Ballkanin Perëndimor një zonë të orientuar nga perëndimi, duke jetuar në paqe dhe duke ndarë vlerat e Aleancës. Faleminderit, edhe një here.

TV ABC Albania: Një pyetje sekretarit të Përgjithshëm. Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë i ka dërguar një letër zyrtare Komandantit Suprem të Aleatëve të Evropës, ku kërkohet të vendosen baza ushtarake detare në Shqipëri. Si i konsideron NATO këto baza ushtarake detare dhe a është në interes të NATO-s të ketë baza të tilla në Shqipëri?

Jens Stoltenberg/Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Para së gjithash, Shqipëria luan një rol të

rëndësishëm në NATO. Kjo është e rëndësishme për Shqipërinë, është e rëndësishme për NATO-n dhe, siç përmenda, tani kemi një program ku investojmë në një bazë ajrore operative në Shqipëri. Deri më tani nuk është marrë asnjë vendim për ndonjë investim shtesë në një bazë detare, por kjo është diçka që vlerësohet nga Autoritetet tona Ushtarake dhe ekspertët tanë ushtarakë dhe, bazuar në atë, NATO do të marrë vendime.

TV ABC Albania: Dhe për Presidentin e Shqipërisë. A ndani shqetësimin për krizën politike në Shqipëri me Sekretarin e Përgjithshëm dhe cila është zgjidhja juaj për të kapërcyer këtë krizë? Faleminderit.

Ilir Meta/President i Shqipërisë: Ne kemi diskutuar me Sekretarin e Përgjithshëm për rëndësinë e vazhdimësisë së zgjerimit të BE në rajonin tonë, sepse NATO dhe BE janë shumë plotësuese dhe në këtë kornizë, ne të dy kemi shprehur zhgënjimin tonë për mungesën e vendimit i Këshillit të fundit të BE për hapjen e bisedimeve të pranimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Por siç nënvizua, si me Presidentin e Maqedonisë së Veriut dy ditë më parë në Tiranë, ne jemi të vendosur të dyfishojmë përpjekjet tona për të vazhduar përmbushjen e këtij qëllimi strategjik të dy vendeve tona, që është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, dhe për të punuar ngushtë me të gjitha vendet anëtare, për të adresuar të gjitha shqetësimet e tyre. Dhe në lidhje me situatën politike në Shqipëri, unë mendoj se duhet të marrim ende në konsideratë porositë e duhura që Sekretari i Përgjithshëm dha gjatë vizitës së tij në pranverë në vendin tone, duke nënvizuar dialogun dhe forcuar rëndësinë e të kuptuarit që në zemër të NATO-s është demokracia. Dhe jam i sigurt se do të dyfishojmë përpjekjet tona për të punuar në këtë drejtim. Dhe pasi ne jemi një anëtar shumë i besueshëm i NATO-s, të jemi shumë shpejt edhe

shumë të besueshëm për të vazhduar rrugën tonë për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kanali TV i Bjellorusisë: Unë kam pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm. Bëhet fjalë për situatën afër kufijve lindorë të NATO-s, dua të them kufirin me Bjellorusinë. Kështu që, disa ditë më parë, Presidenti i Bjellorusisë tha që trupat amerikane në Lituani me stërvitjet e ardhshme, "European Defender 2020", krijojnë tension në këtë rajon dhe kështu Bjellorusia duhet të marrë disa masa kundër tij. Dhe e di që disa prej tyre u vendosën pikërisht sot. Ndoshta ju keni disa mesazhe për partnerët tuaj nga Bjellorusia?

Jens Stoltenberg/Sekretari i Përgjithshëm i NATO: NATO është një Aleancë mbrojtëse dhe natyrisht të gjitha kombet kanë të drejtë të ushtrojnë trupat e tyre, dhe kjo është gjithashtu rasti për Aleatët e NATO-s. Dhe ne ushtrojmë së bashku. Exactly është pikërisht kjo që NATO ka bërë për 70 vjet, që kur u themelua në 1949. Ajo që ne bëjmë është që ne e kemi parë sigurisht që, sepse jemi përballë një ambienti më të paparashikueshëm, më sfidues, më të vështirë të sigurisë, ne kemi rritur përpjekjet tona kur bëhet fjalë për stërvitje ushtarake. Ne kemi ushtrime më të mëdha dhe kemi rritur gatishmërinë e forcave tona. Gjëja e rëndësishme është që kur shohim rritje të aktivitetit ushtarak përgjatë kufijve tanë, atëherë është e rëndësishme që të kemi parashikueshmëri, transparencë, dhe kjo është saktësisht ajo që gjithmonë siguron NATO, që jemi transparent, jemi të parashikueshëm kur bëhet fjalë për ushtrimet tona ushtarake. Dhe gjithashtu Aleatët e NATO-s janë të parashikueshëm dhe transparentë në mënyrën se si ata kryejnë ushtrimet. Pra, një Aleancë mbrojtëse që ushtron forcat e tyre nuk duhet të jetë shqetësuese për asnjë fqinj.

Pergatiti: Mimoza Golikja

Përfundon stërvitja rajonale "Joint Reaction 2019"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, mori pjesë më 24 tetor, në "Ditën e Vizitorëve të Shquar", (DVD), të stërvitjes rajonale "Joint Reaction 2019", e zhvilluar në vendin tonë, në kuadër të iniciativës "US-A5 Adriatic Charter" dhe Memorandumit të Mirëkuptimit, të nënshkruar midis Forcave të Armatosura të vendeve të A-5. Në ceremoninë e DVD të kësaj stërvitjeje, e cila u organizua në mjediset e garnizonit "Skënderbej" dhe në bashkinë Krujë, pas një prezantimi të shkurtër të gjithë skenarëve të kësaj stërvitjeje, një përshëndetje e veçantë për gjithë pjesëmarrësit në këtë stërvitje, u adresua nga SHSHPFA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

"E shoh këtë stërvitje si investimin më të vlefshëm të përbashkët. Qëllimi i saj është bashkëpunimi dhe ndërveprimi midis agjencive kombëtare dhe partnerëve rajonalë të Ballkanit, për vendosjen dhe punësimin në kohë dhe efektiv të aseteve për lehtësimin e fatkeqësive, kur përballemi me një emergjencë të madhe civile, që kërkon një përgjigje gjithëpërfshirëse rajonale. Padyshim ky qëllim u arrit me sukses dhe u arritën të gjitha objektivat e kësaj stërvitjeje, e cila demonstroi se kur bëhemi bashkë, jo vetëm brenda vendit, por dhe si një ekip i përbashkët i zgjeruar civil - ushtarak i Ballkanit, për të punuar, trajnuar bashkëpunuar, demonstroi ndërveprueshmërinë që kemi për të përbashkuar bashkëpunimin e madh civil, duke bërë të mundur promovimin e një qasje gjithëpërfshirëse të shoqërisë, ku të gjithë kemi një rol..."



Stërvitja rajonale "Joint Reaction 2019" është vijim i një serie të stërvitjeve me simulim të Evropës Juglindore, duke filluar në vitin 2002 me projektin "SEESIM" dhe duke vijuar me stërvitjet "Joint Reaction-15" dhe "Joint Reaction-17".



Më tej gjatë përshëndetjes së tij, gjeneral brigade Kollçaku pasi solli në vëmendje të të pranishmëve në këtë ceremoni, aprovimin nga Parlamenti të ligjit për Mbrojtjen Civile duke e konsoliduar në Agjenci Kombëtare për Mbrojtjen Civile, vlerësoi përkushtimin dhe performancën e të gjithë vendeve pjesëmarrëse, përkatësisht Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, SHBA dhe natyrisht Forcat e Armatosura shqiptare, kontribuese e kësaj stërvitjeje. Ai adresoi dhe një falënderim të veçantë për USECOM, për kontributin e jashtëzakonshëm në përgatitjen e kësaj stërvitjeje.

"...Unë mendoj se këto aktivitete mbi të gjitha, përgjatë gjithë këtyre katër ditëve të zhvillimit të kësaj stërvitjeje rajonale, përpos suk-

sesit profesional na shërbejnë të gjithëve për të krijuar kontakte dhe rrjet të ri, duke shkëmbyer ide dhe mendime, duke bërë të mundur që stërvitjet tona të përbashkëta ushtarake dhe angazhimet e përbashkëta të mbeten të garantuara...", - u shpreh gjeneral brigade Kollçaku. "Dita e Vizitorëve të Shquar" e stërvitjes rajonale "Joint Reaction 2019", vijoi më tej në rajonin e Krujës, ku të ftuarit ndoqën nga afër demonstrimin dhe reagimin real të të gjitha strukturave dhe agjencive pjesëmarrëse në këtë stërvitje. Stërvitja rajonale "Joint Reaction 2019" është vijim i një serie të stërvitjeve me simulim të Evropës Juglindore, duke filluar në vitin 2002 me projektin "SEESIM" dhe duke vijuar me stërvitjet "Joint Reaction - 15" dhe "Joint Reaction - 17".

Zhvillohet stërvitja rajonale “Joint Reaction 2019”

Në këtë stërvitje morën pjesë Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shtetet e Bashkuara (USEUCOM), Garda e New Jersey, Kryqi i Kuq Shqiptar, etj.

Në mjediset e Qendrës së Simulimit për tre ditë më radhë, nga data 21 tetor deri në 24 tetor, u zhvillua stërvitja rajonale “Joint Reaction 2019”. Kjo stërvitje u zhvillua në kuadër të nismës “A-5” dhe përbënte një ndër projektet kryesore të kësaj nisme, për sa i përket qasjes gjithëpërfshirëse në çështjet e bashkëpunimit, koordinimit dhe reagimit në fushën e sigurisë. JR-19 ishte dizajnuar si një stërvitje shumëkombëshe, CPX, në nivel rajonal, e asistuar me kompjutera (CAX), në Qendrën e Simulimit të FARSH. Në këtë stërvitje morën pjesë shtete si, Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shtetet e Bashkuara (USEUCOM), Garda e Neë Jersey, Kryqi i Kuq Shqiptar, si dhe aktorë të tjerë të OJQ-ve.

Synimi i kësaj stërvitje ishte përmirësimi dhe rritja e ndërveprueshmërisë midis vendeve dhe organizatave partnere rajonale në mënyrë që të vërtetojë dhe provojë zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta, për sa i përket asistencës në menaxhimin e reagimit emergjent (REMA), në raste të fatkeqësive natyrore.

Qëllimi i “JR-19” ishte që të forcojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis partnerëve rajonal të Gadishullit Ballkanik, në lidhje me mbështetjen, vendosjen dhe aktivizimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aseteve dhe kapac-

iteteve reaguese për përballimin e fatkeqësive në rastet e përballjes me emergjencat civile, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse rajonale. Stërvitja ju mundësoj pjesëmarrësve të planifikojnë dhe ekzekutojnë vendime dhe të ndërmarrin veprime në nivel rajonal, në përgjigje të kërkesave për mbështetjen e operacioneve të emergjencave civile, të injektuara nëpërmjet simulimit.

Shqipëria, si vend pritës, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile, mbikëqyr, menaxhon dhe drejton të gjitha fazat e procesit të zhvillimit dhe ekzekutimit të stërvitjes dhe siguron mbështetjen me simulimin parësor sipas arkitekturës së stërvitjes.

Stërvitja “JR-19” është vijim i një serie të stërvitjeve me simulim të Evropës Juglindore, duke filluar në vitin 2002 me projektin “SEESIM” dhe duke vijuar me stërvitjet “JR-15” dhe “JR-17”.

Mësime e nxjerra, kryesisht ato që lidhen me operacionet, trajnimet e bazuara në simulim, zbatimin e formateve, procedurave dhe standardeve, u zbatuan në stërvitjen “JR-19”. Mësimi më kryesor i nxjerre në projektet paraardhëse, që u adresuan në stërvitjen “JR-19”, ishte nevoja që ka çdo shtet, që objektivat individuale të nivelit kombëtar t’i gershetojë me objektiva gjithëpërfshirëse, në nivel rajonal, me qëllim që të gjitha vendet e rajonit të punojnë së bashku, për të krijuar kohezion, kuptim të përbashkët, veprime e vendime gjithëpërfshirëse, për të përbashkuar lehtësisht çfardo lloji emergjence të zakonshme që mund të ndodh.

FORCA AJRORE

Helikopteri MI-8 në stërvitjen rajonale “Joint Reaction 19”

Nga data 21 deri më 24 tetor zhvillohet në Tiranë stërvitja rajonale “Joint Reaction 19”, e cila përbën një ndër projektet kryesore të nismës së A5, për sa i përket qasjes gjithëpërfshirëse në çështjet e bashkëpunimit, koordinimit dhe reagimit në fushën e Sigurisë. Në këtë stërvitje u angazhua edhe Forca Ajrore, e cila në ditën e Vizitorëve të Shquar (Distinguished Visitors Day), mori pjesë me një helikopter MI-8, duke demonstruar se si ndërvepron kjo forcë në ndihmë të situatave emergjente, konkretisht në transportin e të sëmurëve.

Në këtë stërvitje morën pjesë Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (US-EUCOM) dhe NATO, EADRCC, Garda e New Jersey-it dhe Kryqi i Kuq shqiptar. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është që të forcojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin midis partnerëve rajonal të Gadishullit Ballkanik, në lidhje me mbështetjen, vendosjen dhe aktivizimin në kohë dhe në mënyrë efektive të aseteve dhe kapaciteteve reaguese për përballimin e fatkeqësive në rastet e përballjes me emergjencat civile, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse rajonale.



STËRVITJA “JOINT REACTION 19”

Komanda Mbështetëse mori pjesë me dy skuadra kërkim-shpëtimi

Në stërvitjen rajonale “Joint Reaction 19” që u zhvillua në datat 21-24 tetor, në kuadër të Iniciativës “US-A5 Adriatic Charter” për Emergjencat Civile, Komanda Mbështetëse me efektivët e BMR mori pjesë si forcë operacionale me dy skuadra kërkim-shpëtimi dhe shtatë mjete të vendosura në rajonet e përcaktuara të stërvitjes, duke përmbytur detyrimet për ngritjen e kampingu dhe mbështetjen me setin fushor, e gatshme për veprim për stërvitjen rajonale, sipas skenarëve të parashikuar për EC. Stërvitja u zhvillua njëkohësisht në Qendrën e Simulimit në FARSH dhe në terren në Krujë, me forcat dhe mjetet e BMR. Qëllimi i stërvitjes është forcimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis partnerëve rajonalë për vendosjen dhe aktivizimin në kohë dhe me efikasitet të aseteve dhe kapaciteteve reaguese në raste emergjencash, me trupa ekzekutuese në terren, forcat e mjetet e BMR në bashkëpunim me agjencitë e tjera të Mbrojtjes Civile në kohë reale, me veprimeve në mbështetje të popullsisë në rast tërmetesh. Kjo stërvitje i shërben më së miri unifikimit të veprimeve në rast emergjencash, situata të cilat Komanda Mbështetëse me forcat dhe mjetet e saj i ka përbashkuar që në momentet e para të reagimit me tërmetin e 21 shtatorit dhe më pas me përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut në Valias dhe Bran.

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua më 1 tetor 2019, ceremonia e veçantë, me rastin e zëvendësimit të atashut ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar për vendin tonë, nënkolonel Edward Melotte, i cili përfundon detyrën si atashë ushtarak në Shqipëri dhe marrjen e detyrës nga nënkolonel Christopher Maycock.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm ministrija e Mbrojtjes Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ambasadori britanik në vendin tonë, z. Duncan Norman, përfaqësues të ambasadës angleze, si dhe drejtorë të drejtorive në MM dhe SHP.

Ministria Xhaçka në përshëndetjen e saj vlerësoi punën dhe kontributin e nënkolonel Melotte në forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve tona dhe e nderoi nënkolonel Melotte me "Certifikatë Mirënjohje", me motivacionin "Për kontributin e dhënë nëpërmjet punës së tij si atashë ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, në drejtim të forcimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes, midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar".

Nënkolonel Melotte falënderoi për zemërsisht ministren e Mbrojtjes Olta Xhaçka për bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak mes dy vendeve. Më pas, atashë ushtarak në ikje i

"Certifikatë Mirënjohje" për nënkolonel Edward Melotte

"Për kontributin e dhënë nëpërmjet punës së tij si atashë ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar, në drejtim të forcimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit dypalësh në fushën e Mbrojtjes, midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar".



Mbretërisë së Bashkuar, nënkolonel Edward Melotte dhe pasardhësi i tij në detyrë nënkolonel Christopher Maycock, u pritën në një takim të veçantë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Gjeneral brigade Kollçaku pasi falënderoi nënkolonel Melotte për kontributin e tij të shkëlqyer në rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona i akordoi atij në shenjë mirënjohje "Certifikatë

Mirënjohje".

Nga ana e tij, nënkolonel Melotte, falënderoi Shtabin e Përgjithshëm dhe gjeneral brigade Kollçakun për mbështetjen e dhënë duke nënvizuar se puna e tij është bërë më e lehtë falë kësaj mbështetjeje. Në fund të takimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku i nderoi atashut ushtarak britanik, nënkolonel Maycock mirëseardhjen dhe shumë suksese në detyrën e sapomarrë.

Bashkëpunim me Francën në fushën e mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, priti më 12 tetor 2019, në një takim delegacionin francez të Institutit të Studimeve të Larta të Mbrojtjes (Institut des Hautes Études de Défense Nationale-IHEDN), të kryesuar nga ambasadorja e Francës në vendin tonë, shkëlqesia e saj zonja Kristina Vasak dhe atashë ushtarak francez kolonel Fabrice Duda. Gjeneral brigade Kollçaku, gjatë takimit, pasi e ka falënderuar ambasadorën e Francës, znj. Vasak për kontributin që Franca ka dhënë në mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë në rrugën e integritimit euroatlantik, vlerësoi

Stërvitje, dislokime, trajnime dhe kurse arsimimi

Gjeneral brigade Kollçaku, priti delegacionin francez të Institutit të Studimeve të Larta të Mbrojtjes

nivelin aktual të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona në fushën e Mbrojtjes, që nga dislokimet e përbashkëta, trajnimet dhe stërvitjet e përbashkëta si dhe kurset e arsimimit në institucionet arsimore ushtarake franceze. Pas takimit që shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku zhvilloi me ambasadorën e

Francës në vendin tonë, shkëlqesia e saj zonja Kristina Vasak dhe atashë ushtarak francez kolonel Fabrice Duda, për delegacionin francez të Institutit të Studimeve të Larta të Mbrojtjes, u zhvillua një prezantim mbi arritjet më të fundit të Forcave të Armatosura shqiptare si dhe u diskutua mbi çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes në rajon dhe më gjerë.

Forca Tokësore

Batalioni i II i Këmbësoresë, stërvitje dislokuese në Gjirokastrë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar dhe nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai, mori pjesë në "Ditën e Hapur", të organizuar në qytetin e Gjirokastrës nga Batalioni i II i Këmbësoresë (b2k), i Forcës Tokësore, në kuadër të stërvitjes "Shqiponja 19-02", me praninë e rreth 100 mjeteve dhe 320 trupave të cilat u zhvendosën brenda ditës nga baza e tyre në Zall-Herr, për në Arshi Lengo të Gjirokastrës.

Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje ishte rritja e aftësive të Shtabit të b2k në planëzimin dhe zhvillimin e planeve për kryerjen e dislokimeve nga rajoni i përqendrimit të përhershëm, për në rajonin e përqendrimit të përkohshëm, për të marrë detyra operacionale sipas urdhrave dhe udhëzimeve për operacionet luftarake dhe joluftarake. Testimi i kapaciteteve dislokuese të Batalionit II të Këmbësoresë, vjen edhe si rrjedhojë e të qenit pjesë e rezervës operacionale të misionit të NATO në Kosovë, KFOR.

Gjatë lëvizjes mbi 230 km larg rajonit të përqendrimit të përhershëm, trupat e b2k testuan aftësitë edhe për zënien dhe sigurimin e pikave kyçe të terrenit gjatë lëvizjes. Përveç efektivëve të b2k, u testuan edhe kapacitetet e strukturave ndihmëse si Komanda Mbështetëse dhe Policia Ushtarake. Stërvitja e koduar "Shqiponja 19-02", kishte për qëllim edhe bashkëpunimin me autoritetet e pushtetit vendor dhe rritjen e besimit të popullsisë lokale ndaj Forcave të Armatosura.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, gjatë takimit me trupat e b2k i përgëzoi ata për të gjitha stërvitjet e realizuara me sukses. "Ju përgëzoj për këtë organizim kaq

Stërvitja e koduar "Shqiponja 19-02", kishte për qëllim edhe bashkëpunimin me autoritetet e pushtetit vendor dhe rritjen e besimit të popullsisë lokale ndaj Forcave të Armatosura.



perfekt të "Ditës së Hapur" këtu në Gjirokastrë. Batalioni II i Këmbësoresë përherë ka treguar se di të jetë në lartësinë e detyrës sa herë që është kërkuar angazhimi i tij. Sot ju keni mundësinë që me krenari t'i tregoni popullsisë civile se kush jeni dhe t'u demonstroi një pjesë nga jeta juaj e përditshme ushtarake. Ju, sot, mbi të gjitha, keni mundësinë që nëpërmjet ekspozimit të mjeteve, armatimit dhe pajisjeve që ju keni në përdorim, t'i tregoni popullsisë lokale se si administrohen lekët e taksapaguesit shqiptar nga Forcat e Armatosura, që janë vërtet krenari për vendin ...", - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku.

Ndër vizitorët e shumtë, që kishin mbushur sheshin në qendër të qytetit, ishin edhe personalitete të pushtetit vendor si kryetarja e Qarkut të Gjirokastrës znj. Lindita Rova dhe kryetari i Bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, të cilët në takimin që zhvilloan me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçakun, vlerësuan me nota pozitive këtë iniciativë të Forcave të Armatosura duke falënderuar të gjithë ushtarakët e pranishëm për organizimin e kësaj dite si dhe shprehën njëkohësisht

edhe mirënjohjen dhe respektin e veçantë për Forcat e Armatosura, për mbështetjen që i kanë dhënë popullsisë civile sidomos në rastet e Emergjencave Civile.

"Dita e Hapur" shfaqti interes të veçantë sidomos nga të rinjtë gjirokastritë, të cilët patën rastin të njihen nga afër dhe të informohen më gjerë në lidhje me punën e përditshme që kryejnë trupat ushtarake, në interes të realizimit të misionit të tyre fisnik. Nëpërmjet standave ekspozuese të ngritura nga efektivët e b2kFT, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Qendrën e Personel-Rekrutimit (QPR), vizitorët u njohën jo vetëm me armatimin dhe pajisjet, por patën mundësinë të marrin edhe një informacion më të plotë dhe të detajuar, se si mund të rekrutohen për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Stërvitja dislokuese "Shqiponja 19-02", përveç zhvillimit të "Ditës së Hapur" në fokus të saj pati edhe kontributin për popullsinë lokale në rajonin e zhvillimit të saj, ku efektivët e b2kFT kanë ndërhyrë për rehabilitimin e ambienteve sportive në shkollën e mesme të bashkuar "Bilal Golemi" në njësinë administrative Cepo.

Misioni i NATO-s “Aegean Sea”

Forca Detare: Kontingjenti i 14-të nis drejt detit Egje

Kontributi i Forcave të Armatosura shqiptare në misionin e NATO “Sea Guardian” do të vijojë me Kontingjentin XIV, i cili u nis më 11 tetor 2019, nga Porti i Durrësit për në detin Egje. Në përcjelljen e detarëve shqiptarë ishte i pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiteni i rangut I Artur Meçollari, prefekti i Durrësit Roland Nasto, efektivë të flotës si dhe familjarë të ushtarakëve që janë pjesë e kontingjentit.

Zëvendësministri Koçi e vlerësoi angazhimin e detarëve tanë në detin Egje si një kontribut për sigurinë e gjithë Evropës dhe u uroi erëra të mbara kontingjentit të radhës. “Migracioni i paligjshëm nuk sjell vetëm destabilitet shoqëror por sjell edhe rreziqe të terrorizmit sepse mbart shpesh me vete elementë të ekstremizmit të dhunshëm. Ky është një kontribut ushtarak i Republikës së Shqipërisë që pikërisht Evropa të mos ketë më pasoja të tilla. Prandaj në këto ditë ku diskutohet hapja e mundshme e negociatave të BE me Shqipërinë për anëtarësim, ky është një kontribut që na e ngre kokën lart sepse është një shërbim që ne i bëjmë Evropës së bashkuar. Dhe kjo falë vendimeve të qeverisë së Republikës së Shqipërisë, por natyrisht edhe kontributit konkret të Forcave tona



Kontingjenti i anijes “Lissus” përbëhet nga 21 ushtarakë, mes të cilëve edhe 2 femra

të Armatosura dhe në mënyrë të veçantë të Forcës sonë Detare. Me kontingjentin e sotëm, numri i efektivëve të angazhuar deri tani në këtë mision shkon rreth 300, që është me të vërtetë një shifër e konsiderueshme për një vend të vogël si Shqipëria.”

Zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiteni i rangut I Artur Meçollari përmendi vlerësimet nga aleatët që kontingjentet shqiptare kanë marrë për kontributin në detin Egje dhe falënderoi në mënyrë të veçantë për mbështetjen dhe sakrificat,

familjarët e ushtarakëve që kanë shërbyer në mision.

Kontingjenti XIV do të patrullojë në zonën e operacionit me anijen Oriku dhe komandohet nga kapiteni i rangut III Albion Bitraj.

Kontingjenti përbëhet nga 21 ushtarakë, mes të cilëve edhe 2 femra. Shqipëria kontribuon prej 3 vitesh në operacionin e NATO në detin Egje, ku kanë shërbyer rreth 300 efektivë dhe 3 anije, të cilët kanë realizuar mijëra orë patrullime, duke shpëtuar dhe parandaluar qindra emigrantë të paligjshëm.



Paraditen e datës 24 tetor, e enjte 2019, atasheu i ri britanik, nënkolonel Christopher Maycok, zhvilloi një vizitë kortezie në Komandën e Forcës Detare, ku u prit nga zëvendëskomandanti i FD, kapiten i rangut të parë Artur Meçollari, i cili i uroi mirëseardhjen dhe fat të mbarë në detyrën e re. Gjatë takimit, atasheu ushtarak britanik me rastin e marrjes të detyrës bëri prezantimin e tij dhe vazhdoi me diskutimin për bashkëpunimin ushtarak midis dy vendeve. Në përfundim të takimit kapiten i rangut të parë Meçollari e falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm dhe shprehu besimin e plotë për vijimin e këtij bashkëpunimi.

Nënkolonel Christopher Maycok

Atasheu i Britanisë së Madhe në Komandën e Forcave Detare

Nënkolonel Christopher Maycok u prit nga zëvendëskomandanti i FD, kapiten i rangut të parë Artur Meçollari



Misioni i NATO-s, "Sea Guardian"

Kontingjenti XIII kthehet nga misioni në detin Egje

Me rastin e kthimit të Kontingjentit XIII pjesëmarrës në operacionin "Sea Guardian" në detin Egje, në Flotiljen Detare Pashaliman u zhvillua më 21 tetor, ceremonia për pritjen e 21 efektivëve. Në ceremoni mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari, zëvendëskomandanti i Flotiljes Detare kapiten i rangut II Dritan Sera, si dhe personeli i Flotiljes Detare Pashaliman.

Kapiten i rangut I Meçollari në emër të Forcës Detare falënderoi dhe shprehu mirënjohjen për përkushtimin që treguan gjatë kohës së qëndrimit në zonën e operacionit dhe përmbushjen me sukses të misionit. Ndër të tjera ai u shpreh se Kontingjenti i XIII për gati dymbëdhjetë javë ka kryer tetëmbëdhjetë operacione duke identifikuar dhe shpëtuar 351 emigrantë. Gjithashtu pesë operacione asistence me Rojën Bregdetare turke dhe FrontEx duke shpëtuar 210 emigrantë. Në total Kontingjenti i XIII ka shpëtuar 551 emigrantë.

Të gjitha strukturat e Aleancës dhe vendet aleate kanë vlerësuar me notat maksimale pjesëmarrjen, përkushtimin dhe profesionalizmin e personelit të Forcës Detare.

Kontingjenti i XIII për gati dymbëdhjetë javë ka kryer tetëmbëdhjetë operacione duke identifikuar dhe shpëtuar 351 emigrantë



Një falënderim të veçantë iu përcollti familjarëve të tyre, pasi kanë qenë dhe mbeten mbështetja kryesore dhe e pazëvendësueshme. Roli i efektivave dhe anijes shqiptare në këtë operacion është raportimi i trafikut të emigrantëve në zonën operacionale dhe ndërhyrja duke ofruar ndihmë në rastet kur konstatohet se jetët njerëzore janë në rrezik.

Ndërkohë, para pak ditësh, më 11 tetor, u nis drejt detit Egje, Kontingjenti XIV, i Forcave Detare.

Kontingjenti XIV do të patrullojë në zonën e operacionit me anijen Oriku dhe komandohet nga kapiteni i rangut III Albion Bitraj. Kontingjenti përbëhet nga 21 ushtarakë, mes të cilëve edhe 2 vajza. Shqipëria kontribuon prej 3 vitesh në operacionin e NATO në detin Egje, ku kanë shërbyer rreth 300 efektivë dhe 3 anije, të cilët kanë realizuar mijëra orë patrullime, duke shpëtuar dhe parandaluar qindra emigrantë të paligjshëm.



Simpoziumi i XII-të i Fuqive Detare rajonale në Venecia, Itali

Forcat detare kontrollojnë rrugët e komunikimit detar

Nga data 15-18 tetor 2019, zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari, mori pjesë në Simpoziumin XII të Fuqive Detare rajonale në Venecia, Itali. Simpoziumi XII u fokusua kryesisht në tema si e drejta ndërkombëtare e detit, nga Montego Bay tek një model i ri dhe impakti mbi forcat detare, ri formatimi i forcave detare drejt detit të hapur, si dhe evolucioni i konceptit të fuqisë detare drejt shekullit të detit.

Në tre ditët e simpoziumit të gjithë folësit theksuan se shekulli XXI është Shekulli i Detit, fakt i cili ka nevojë për përmirësime ligjore në të Drejtën Ndërkombëtare të Detit, zhvillimin e forcave detare me kapacitete për në det të hapur, por dhe mision me spektër më të gjerë, për mbrojtjen e interesave kombëtare dhe imponimin e ligjit në det.

Forcat detare kanë luajtur dhe do të vazhdojnë të luajnë një rol vendimtar në kontrollin e rrugëve të komunikimit detar, mbrojtjen e interesave kombëtare ndaj sfidave dhe kërcënimeve që vijnë nga deti, mbrojtjen e burimeve detare dhe nëndetare në shelfin kontinental dhe zonën ekonomike ekskluzive,



Zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari, mori pjesë në Simpoziumin XII të Fuqive Detare rajonale në Venecia, Itali

mbrojtjen e jetës dhe pasurisë në det, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe diversitetit detar. Forcat detare do të vazhdojnë të jenë agjenci lider në bashkëpunimin ndërinstitucional.

Një ditë e veçantë gjatë simpoziumit ju kushtua iniciativës Adrion. Në ditën e parë të tij në bordin e anijes "Amerigo Vespuçi" u organizua takimi i ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Iniciativës dhe takimi i komandantëve të forcave detare. Qëllimi i takimeve ishte diskutimi në një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimit mbi të ardhmen e iniciativës drejt një angazhimi më të madh në garantimin e sigurisë detare rajonale.

Gjatë ditëve të simpoziumit zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari pati mundësi të bashkëbisedoj për çështje me interes të përbashkët me komandantët e forcave detare të vendeve të rajonit, të Italisë, Greqisë, Malit të Zi, Kroacisë dhe Sllovenisë, si dhe Komandanti e Forcave Detare të SHBA dhe Komandës së Bash-

kuar të NATO në Napoli. Kapiten i Rangut I Artur Meçollari pati një takim të veçantë me komandantin e Forcave Detare të NATO (MARCOM) nënadmiralet Keith E. Blount, me të cilin diskutuan mundësitë e rritjes së bashkëpunimi midis Forcës sonë Detare dhe MARCOM në të ardhmen.



Paraditen e datës 2 tetor, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, bëri një vizitë në Garnizonin e Pashalimanit, ku u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari si dhe efektivë të këtij garnizoni. Gjeneral brigade

Gjeneral Brigade Kollçaku inspekton stërvitjen “Limani-19”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku inspektoi më 2 tetor 2019, stërvitjen kompaktësuese të koduar “Limani-19”, e cila u zhvillua në Flotiljen Detare Pashaliman, Vlorë. Në këtë stërvitje kompaktësuese morën pjesë elementë nga shtabi dhe toga e kompanisë së dytë operacionale e Policisë Ushtarake dhe një grup bordingu i Forcës Detare. Në përshëndetjen e tij drejtuar pjesëmarrësve në këtë stërvitje, gjeneral brigade Kollçaku pasi i përgëzoi për realizimin me sukses të kësaj stërvitjeje u shpreh se kjo stërvitje shërben për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale si për bordingun konsensual dhe jo konsensual të Forcës Detare, por edhe për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të Policisë Ushtarake për marrjen dhe ruajtjen e objekteve.

Më pas shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i shoqëruar edhe nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari, zhvilloi një takim me ekipin

“ Kjo stërvitje shërben për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcës Detare



e zhytjes, të cilët u certifikuan pas mbarimit të Kursit Bazë të Zhytjes, si dhe i ka akorduar dy efektivëve të Forcës Detare “Medalje Shpëtimi”, me motivacionin “Të dalluar për heroizmin në shpëtimin e jetës së njeriut, duke rrezikuar jetën e tyre”. Gjeneral brigade Kollçaku, duke vlerësuar misionin e vështirë që ka

kjo strukturë u shpreh se realizimi i tij është i mundur vetëm në sajë të trajnimit dhe bashkëpunimit në operacionet që zhvillojmë së bashku, që kjo traditë e filluar me Gardën e Republikës dhe strukturat e tjera të Policisë së Shtetit të vazhdojë. “Vetëm kështu ne jemi në gjendje të ndajmë eksperiencat më të mira me njëri-tjetrin. Qendrën e Zhytjes dua ta falënderoj jo vetëm për këtë trajnim, por edhe për gatishmërinë e treguar në shumë misione si brenda ashtu edhe jashtë vendit në kuadër të operacioneve të NATO”, u shpreh gjeneral brigade Kollçaku.

Më herët, gjeneral brigade Kollçaku inspektoi Qendrën e Personel Organizimit dhe Stacionit Meteorologjik, në qytetin e Vlorës. Gjeneral brigade Kollçaku në takim me ekipin e zhvilluar në QPR, Vlorë vuri theksin në rritjen e bashkëpunimit me shkollat e mesme, me qëllim promovimin e vlerave të FA te të rinjtë, që ata të jenë sa më pranë dhe sa më atraktiv për t’iu bashkuar Forcave të Armatosura në arsimim dhe jo vetëm.

Gjeneral brigade Kollçaku, viziton Garnizonin e Pashalimanit

Kollçaku, i shoqëruar edhe nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i rangut I Artur Meçollari, zhvilloi një takim me ekipin e zhytjes, të cilët u certifikuan pas mbarimit të Kursit Bazë të Zhytjes, si dhe u akordoi dy efektivëve të Forcës Detare “Medalje Shpëtimi”, me motivacionin “Të dalluar për heroizmin në shpëtimin e jetës së njeriut, duke rrezikuar jetën e tyre”.

“Qendrën e Zhytjes dua ta falënderoj jo vetëm për këtë trajnim, por edhe për gatishmërinë e treguar në shumë misione si brenda ashtu edhe jashtë vendit në kuadër të operacioneve të NATO-s”, u shpreh gjeneral brigade Kollçaku. Gjithashtu gjeneral brigade Kollçaku zhvilloi edhe një vizitë në Qendrën e Stërvitjes, ku zhvillohet Kursi Bazë i Oficerit në specialitetin Detari.

Bashkëpunim midis Forcës sonë Detare dhe Flotës greke

Në zbatim të planit të bashkëpunimit ushtarak dypalësh midis Forcës sonë Detare dhe flotës greke, në datat 21-23 tetor në Komandën e Forcës Detare u zhvillua takimi ALB-GRC 05, "Naval Staff Talks".

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte diskutimi i realizimit të planit të aktiviteteve për vitin 2019 dhe plani i bashkëpunimit për vitin 2020.

Më datën 22 tetor, ekipi grek i kryesuar nga Kapiten i Rangut të I-rë Michail Pantouvakis, -Drejtor i Drejtorisë së Planeve dhe Politikave në Shtabin e Forcave Detare Greke, zhvilloi vizitë në Komandën e Forcës Detare, ku u prit nga Zv/Komandanti i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të I-rë Artur Mecollari, Shefi i Shtabit i FD, Kapiten i Rangut të II-të Sabri Gjinollari dhe specialist të shtabit.

Gjatë takimit, ushtarakët e dy flotave nënvizuan bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e trajnimit e arësimimit të detarëve shqiptarë, stërvitjet rajonale në kuadër të nismës "Adrijon", bashkëpunimin në operacionin e detit Egje, etj.

Gjithashtu u diskutua për aktivitetet që do realizohen midis dy flotave tona për vitin 2020.

Gjatë qëndrimit në vendin tonë, ushtarakët e Flotës greke zhvilluan visita në qytetin e Durresit, ku u njohën dhe me traditën e detarisë shqiptare, në ekspozitën "Detaria shqiptare në shekuj". Ata vizituan dhe qytetin e Tiranës. Delegacioni i Flotës greke u largua nga vendi ynë më 23 tetor 2019.



Ekipi grek u kryesua nga Kapiten i Rangut të I-rë Michail Pantouvakis, Drejtor i Drejtorisë së Planeve dhe Politikave në Shtabin e Forcave Detare Greke



FORCA DETARE-GARNIZONI PASHALIMAN



Në zbatim të planit të bashkëpunimit ushtarak me Republikën e Rumanisë, nga datat 7 deri më 10 tetor 2019, zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë, Komandanti i Forcës Detare të Rumanisë, Admiral Alexandru Mirsu.

Qëllimi i kësaj vizite ishte rritja e bashkëpunimit ushtarak midis Forcave Detare të dy vendeve dhe studimi i mundësive për shtimin e bashkëpunimit në fusha me interes reciprok, si trajnime dhe stërvitje të përbashkëta.

Më datën 9 tetor 2019, Admiral Mirsu dhe ekipi i tij zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Detare ku u prit nga Zv/Komandanti i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të I-rë, Artur Mecollari, Shefi i Shtabit i FD, Kapiten i Rangut të II-të, Sabri Gjinollari dhe kuadro të shtabit.

Gjatë takimit u diskutua ecuria e bashkëpunimit të deritanishëm midis dy flotave, si ai dy palësh, ashtu dhe në kuadër të aleancës. Ushtarakët e dy vendeve vlerësuan vizitat portuale të anijeve rumune në vendin tone dhe shkëmbimin e përvojës dy palëshe, psh. vizita e anijes shkollë "Mircea" në portin e Durrësit, stërvitjet e përbashkëta me pjesmarrjen e kuadrove të Forcës sonë Detare, pjesmarrja në misionet e NATO-s, misioni "Sea Guardian", në Egje, imbarkimi

Bashkëpunim dy palësh në kuadër të aleancës me flotën rumune

Komandanti i Forcës Detare të Rumanisë, Admiral Alexandru Mirsu, vizitoi Komandën e Forcës sonë Detare



i kuadrove tanë në anijet e Flotës Rrumune, etj.

Në fund të takimit u nënvizua thellimi i bashkëpunimit midis dy flotave tona, në fusha me interes reciprok, sidomos në stërvitje e trajnime dy palëshe.

Në vijim të vizitës në Forcën Detare, Admiral Alexandru Mirsu zhvilloi një vizitë në anijen "Iliria", me vendbazim në portin e Durrësit.

Ndërsa vlerësoi nivelin e detarëve tanë, Admirali Mirsu falenderoi Zv/

Komandantin e Forcës Detare për mikpritjen e treguar gjatë vizitës së tij 3 ditore në Shqipëri.

Gjithashtu ushtaraku më i lartë i Flotës rumune dhe ekipi i tij zhvilluan vizita në Durrës, Tiranë e Krujë.

Admiral Mirsu u prit në takim të veçantë dhe nga Shefi i Shtabittë FA, Gjeneral-brigade Bardhyl Kollcaku. Më datën 10 tetor, Komandanti i Forcës Detare rumune u largua nga vendi ynë.

Fillon Kursi Bazë i Oficerit të Forcës Detare

Në mjediset e Garnizonit të Pashalimanit, u zhvillua më 1 tetor 2019, ceremonia e fillimit të Kursit Bazë të Oficerit të Forcës Detare. Në ceremoni morën pjesë komandanti i Qendrës së Zhytjes Pashaliman kapiten i rangut I Festim Derri, komandant i Qendrës Stërvitore kapiten i rangut II Bamir Likaj si dhe personeli i kësaj qendre.

Kursantët u përshëndetën nga komandanti i Qendrës

Stërvitore të Forcës Detare, kapiten i rangut II Likaj, i cili në fjalën e tij theksoi: "Sot fillon Kursi Bazë i Oficerit (KBO) të Forcës Detare; është kurs institucional, që shërben si kusht për marrjen e gradës së radhës."

Kapiten i rangut II Likaj iu uroi suksese dhe kërkoi nga kursantët: disiplinë, angazhim serioz, mobilizim dhe përkushtim gjatë gjithë periudhës së kursit, me qëllim asimilimin

dhe përvetësimin e plotë të programit mësimor dhe stërvitor të këtij kursi si dhe arritjen e rezultateve sa më të larta në përfundim të tij.

Në kurs marrin pjesë 10 oficerë, të sapo emëruar në Forcën Detare. Kursi Bazë i Oficerit të Forcës Detare (KBO), zhvillohet në 24 javë mësimore, ku do trajtohen tema të ndryshme si njohuri të lundrimit detar, manovrimi taktik, historiku i Forcës Detare etj.

Në datat 21-22 tetor, Forca Tokësore e kryesuar nga gjeneral brigade Albert Mullai zhvilloi një vizitë zyrtare në Kosovë në kuadër të bashkëpunimit bilateral ushtarak mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.

Kjo vizitë u zhvillua me ftesë të komandantit të Brigadës së Reagimit të Shpejtë të FSK, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj dhe kishte si qëllim thellimin e bashkëpunimit ushtarak nëpërmjet shkëmbimit të përvojës dhe eksperiencës ushtarake mes dy komandave.

Komandanti i Forcës Tokësore në takim me gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj pasi u njoh me misionin, objektivat dhe procesin e transformimit të FSK, gjithashtu pa nga afër Komandën e Brigadës së Reagimit të Shpejtë, nëpërmjet stacioneve të ngritura nga efektivi e Batalionit të Dytë që dislokohe pranë kësaj komande.

Gjatë qëndrimit të tij dy ditore në Kosovë, komandanti i Forcës Tokësore pati një takim zyrtar me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, z. Qemal Minxhozi, i cili i bëri me dije gjeneral brigade Albert Mullait marrëdhëniet e shkëlqyera në të gjitha fushat e bashkëpunimit mes dy vendeve tona, sidomos në sferën e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe se si ky bashkëpunim ka të gjitha mundësitë që të zhvillohet më tej. Në vijim të vizitës së

Shqipëri-Kosovë: Bashkëpunim midis forcave të armatosura

Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai, vizitë zyrtare në Forcën e Sigurisë së Kosovës



tij, zëvendësministri i Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës Burim Ramadani priti në takim komandantin e Forcës Tokësore dhe stafin e tij shoqëruar. Ai falënderoi komandantin e Forcës Tokësore për gatishmërinë e treguar për të intensifikuar bashkëpunimin e ndërsjellët ushtarak. Duke vijuar takimet me zyrtarët e lartë të FSK, komandanti i Forcës Tokësore u prit nga shefi i Shtabit të Përgjith-

shëm, gjeneral brigade Jeton Dreshaj dhe më pas zhvilloi një vizitë njohëse në Qendrën për Studime Universitare të FSK, qendër në të cilën studiojnë dhe tre kadetë nga Shqipëria. Qëllimi i kësaj vizite ishte zhvillimi i mëtejshëm i planeve dhe stërvitjeve dypalëshe i trupave të Forcës Tokësore dhe BR-SHFSK me synim rritjen profesionale të efektiveve nëpërmjet shkëmbimit të përvojës ushtarake.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e FA

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e FA, në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në kuadër të realizimit të programit mësimor zhvilloi para disa ditësh një vizitë dy ditore në mësimore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës

Qëllimi mësimor i vizitës së KLSM-së ishte njohja me institucionet e sigurisë shtetërore dhe ndërkom-bëtare që operojnë në Kosovë, dhe se si është institucionalizuar koncepti i sigurisë bashkëpunuese në rastin e Kosovës.

Kursi i drejtuar nga Zv/komandanti i AFA, Kolonel Edmond Braneshi, Shefi i Seksionit të Grupit të Studimeve Strategjike,

Delegacioni nga Shqipëria u prit nga drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritim Euro-Atlantik, kolonel Agron Bajrami dhe kolonel Haki Hoti, drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim, të cilët në emër të drejtuesve të Ministrisë së Mbrojtjes përshëndetë mysafirët dhe vlerësuan lart vizitën e kursantëve.

Në emër të drejtuesve të Minis-

Vizitë dy ditore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK

Kursantët ishin nga Shqipëria, Greqia, Britania e Madhe, Gjeorgjia, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Italia

trisë së Mbrojtjes, drejtori i Departamentit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritim Euro-Atlantik, kolonel Agron Bajrami, i përshëndeti kursantët duke vlerësuar vizitën e kursantëve nga Shqipëria, Greqia, Britania e Madhe, Gjeorgjia, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Italia.

Më pas, kolonel Haki Hoti, drejtor i Departamentit për Transformim, Modernizim dhe Standardizim, bëri një prezantim lidhur me historikun e ngritjes, zhvillimit dhe tranzicionit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, duke filluar nga Rishikimi i Strategjisë së Sektorit të Sigurisë së Kosovës, miratimi i ligjeve për Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në dhe tani për

Procesin Gjithpërfshirës të Tranzicionit të Forcës.

Në vijim, oficerët e lartë, pjesë e delegacionit të KLSM-së, vizituan edhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së në kazermën Adem Jashari në Prishtinë si dhe Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në kazermën "Skënderbeu" në Ferizaj, ku u njohën nga afër me misionin, detyrat dhe aktivitetet e këtyre institucioneve.

Gjatë vizitave dhe takimeve, me anë të pyetjeve të shumta, kursantët shprehën interesimin e tyre për tematikën e prezantuar lidhur me ngritjen dhe zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, procesin e tranzicionit dhe planet për zhvillimin e saj në të ardhmen.

Gjeneralmajor Hazrolli leksion në Akademinë e Forcave të Armatosura

Drejtori i Drejtorisë për Inteligjencë dhe Siguri në Ministrinë e Mbrojtjes, gjeneralmajori i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK-së) Gëzim Hazrolli me ftesë të Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është ftuar të ligjëroi në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM). Gjeneral Hazrolli në një takim zyrtar u prit nga komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), gjeneral brigade Bajram Begaj.

Gjatë takimit të dy gjeneralët biseduan për bashkëpunimin e vazhdueshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe vazhdimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.

Gjeneral Hazrolli në ambientet e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes ligjëroi para një audience të gjerë ushtarake dhe civile të strukturave të larta të Forcave të Armatosura dhe përfaqësuesve të in-



stitucioneve të sigurisë të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe përfaqësues nga vendet e rajonit dhe të NATO-s, lidhur me temën „Mjedisi kombëtar i sigurisë dhe bashkëpunimi

mes agjencive“. Më pas, gjeneral Gëzim Hazrolli takoi edhe oficerët e lartë të FSK-së të cilët gjenden për trajnime/kurse të karrierës në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunim FA-FSK

Në Qendrën Stërvitore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) përfundoi Kursi për eliminimin e mjeteve eksplozive të pashpërthyer (Explosive Ordnance Disposal) niveli i II-të, ku përveç pjesëtarëve të FARSH-it morën pjesë edhe 5 pjesëtarë të Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), dy prej të cilëve ishin në cilësinë e instruktorëve, ndërsa tre të tjerë kursantë.

Në këtë ceremoni të pranishëm ishin shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, atashu ushtarak i Kosovës, kolonel Bashkim Shillova, atashu ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës i akredituar në Shqipëri, kapiten i rangut II James Hilton, drejtorë të drejtorive në SHP, si dhe komandantë të strukturave vartëse.

Kursi u realizua në periudhën kohore prej 16 shtatorit deri më 11 tetor 2019. Në ceremoninë përmbyllëse të kursit, para të gjithë mysafirëve kursantët demonstruan asgjësimin e një pakoje të improvizuar me mjete eksplozive (Improvised Explosive Device), si dhe heqjen nga një djegore të një predhe 152 milimetrash. Instruktori nga Forca e Sigurisë së Kosovës, tetar Roland Reshitaj, shprehet se ndihet mjaft i privilegjuar që është instruktor i kursantëve që janë pjesë e NATO-s. “Për mua është privilegj dhe

Përfundoi kursi për eliminimin e mjeteve eksplozive

Morën pjesë 5 pjesëtarë të Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK): dy instruktorëve dhe tre kursantë

përgjegjësi të jem i angazhuar si instruktor i kursantëve në një trajnim të këtij niveli profesional me pjesëtarë të NATO-së, të cilët bartin shumë eksperiencë në misionet e shumta si jashtë shtetit ashtu edhe në detyra të tjera brenda vendit. Edhe ne u mundam që të japim sa më shumë nga eksperiencat tona, që rreziku në detyra reale të reduktohet maksimalisht”. Kurse në emër të kursantëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës përshëndeti tetar Donjeta Krasniqi. Mbikqyrësi i palës amerikane të EUCOM kryekapter David Niedzwiadek, u shpreh tepër i kënaqur për përkushtimin dhe punën e palodhur si të instruktorëve shqiptar dhe atyre të FSK. “Nëpërmjet këtij kursi

ne arritëm që me ndihmën e aleatëve ekspertë amerikanë të certifikojmë instruktorët e parë si në Shqipëri dhe Kosovë, të cilët do të zhvillojnë dhe ruajnë vazhdimësinë e këtyre kurseve në të ardhmen; u shpreh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku. Kursi për eliminimin e mjeteve eksplozive të pashpërthyer (Explosive Ordnance Disposal) niveli i II-të, ishte veçanërisht sfidues për shkak të kurikulës së re dhe pajisjeve të reja, por kursantët e këtij kursi i kaluan të gjitha fazat me profesionalizëm të lartë.

Në përfundim të ceremonisë, për të gjithë kursantët që ishin pjesë e këtij kursi, u ndanë certifikata.



Stërvitje kompaktësuese e grup-batalionit, në Letoni

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, mori pjesë në "Ditën e Vizitorëve të Shquar", të grup-batalionit kanadez të Prezencës së Përparuar të Përforcuar (enhanced Forward Presence- eFP) të NATO, në Letoni.

Qëllimi kryesor i kësaj stërvitje ishte certifikimi dhe deklarimi operacional i të gjithë komponentëve të grup-batalionit të drejtuar nga Kanadaja, përkatësisht Kanadaja, Spanja, Italia, Çekia, Sllovakia dhe Sllovenia si dhe një togë EOD e FARSH.

Në "Ditën e Vizitorëve të Shquar" të gjithë të pranishmit ndoqën nga afër veprime luftarake me forca e mjete në terren në bashkëpunim me të gjithë komponentët operacionale, pjesëmarrës në këtë mision.

Gjatë vizitës në Letoni, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndriçim Sallaku zhvilloi një takim me komandantin e Task-Forcës së NATO në Letoni, kolonel Gaugars si dhe komandantin kanadez të grup-batalionit nëkolonel Mike Reekie, në përbërje të të cilit vepron dhe toga jonë EOD.

Gjatë takimit kolonel Gaugars, pasi falënderoi gjeneral brigade Sallaku për bashkëpunimin u shpreh ndër të tjera: "Grupi shqiptar EOD, ka reflektuar disi-

Gjatë qëndrimit në Letoni, gjeneral brigade Sallaku u takua me komandantin e Task-Forcës së NATO në Letoni, kolonel Gaugars

plinë të lartë e profesionalizëm të spikatur dhe vetëm javën e kaluar ka zgjidhur me sukses detyrat luftarake për asgjësimin e 166 UXO, duke reflektuar kështu përkushtim serioz dhe rezultate të shkëlqyera, si një kontribut i vyer që toga shqiptare EOD i jep misionit eFP në Letoni".

Pas përfundimit të stërvitjes gjeneral brigade Sallaku zhvilloi një takim me personelin e togës tonë EOD, si dhe përcolli mesazhe falënderimi nga ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Pergjithshëm i FARSH për përkushtimin e tyre në detyrën që ata kryejnë në mision.

Gjeneral brigade Sallaku, i shoqëruar nga i gjithë personeli oficer

prezent në bazën Qdaži zhvilluan homazhe në memorialin e dy "Dëshmorëve të Atdheut", major Klodian Tanushi dhe rreshtere Zarife Hasanaj, të cilët ranë në krye të detyrës, në muajin maj të këtij viti në bazën Qdaži në Letoni.

Më herët, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Sallaku, mori pjesë edhe në konferencën "Senior Leader's Forum", i ftuar nga komandanti i Task-Forcës së NATO në Letoni, ku u diskutuan tema mbi gjenerimin e forcave në kuadër të misionit të NATO dhe njëkohësisht u vendos për programin e vitit të ardhshëm.



Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal) niveli II. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrçim Sallaku, atasheu ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës i akredituar në Tiranë kapiten i Rangut II James Hilton, atasheu ushtarak i Kosovës i akredituar në Tiranë kolonel Bashkim Shillova, përfaqësues nga Shtabi Përgjithshëm si dhe komandantët e strukturave vartëse të KM-së.

Ceremonia ndryshe nga herët e tjera filloi me një demonstrim nga kursantët EOD për asgjësimin e një pako të improvizuar IED (Improvised Explosive Device) si dhe heqja nga një djegore nga një predhë 152 mm.

Pas demonstrimit nga grupi EOD, fjalën e hapjes së këtij aktiviteti e mbajti komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zyla, i cili theksoi rëndësinë e veçantë që ka kjo ceremoni duke u shprehur se: "Misioni i këtij kursi EOD është zhvillimi i aftësive teorike dhe praktike për të përcaktuar llojin e municionit, si dhe nëse ky municion është i sigurt për të lëvizur, transportuar dhe asgjësuar në një zonë të sigurt gjë e cila rrit aftësinë dhe ndërveprueshmërinë e ekspertëve tanë me ata të NATO-s. Ky kurs shërben njëkohësisht edhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD brenda dhe jashtë vendit si në operacione luftarake ashtu edhe në ato jo luftarake". Në emër të kursantëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës përshëndeti tetar Donjeta Krasniqi. Përshëndeti në këtë ceremoni dhe mbikqyrësi i palës amerikane të EUCOM kryekapter David Niedzwiadek, i cili u shpreh tepër i kënaqur për përkushtimin dhe punën e palodhur si të instruktorëve shqiptar dhe atyre të FSK. Kursi EOD niveli II ishte veçanërisht sfidues për shkak të kurikulës së re dhe pajisjeve të reja, por kursantët e këtij kursi i kaluan të gjitha fazat me profesionalizëm të lartë.

Në fjalën e tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl

Përfundon me sukses kursin EOD niveli II

Në kursin EOD të nivelit II, morën pjesë 13 vetë, 10 kursantë nga FARSH (kryesisht Batalioni i Xhenios) dhe 3 kursantë nga Forca e Sigurisë së Kosovës



Kollçaku pasi përshëndeti të pranishmit në këtë ceremoni, nënvizoi veçantinë e këtij evenimenti, në një specialitet me kaq interes dhe delikat, sikurse është EOD. Nëpërmjet këtij kursi ne arritëm që me ndihmën e aleatëve ekspertë amerikanë të certifikojmë instruktorët e parë si në Shqipëri dhe Kosovë, të cilët do të zhvillojnë dhe ruajnë vazhdimësinë e këtyre kurseve në të ardhmen.

Duke qenë i një rëndësie të veçantë për vetë rrezikun që mbart në vetvete ky specialitet, kursi u zhvillua me impenjim dhe përkushtim

të madh si në aspektin e përgatitjes profesionale, ashtu edhe nga ana instruktivo-metodike. Në përfundim, gjeneral brigade Kollçaku falënderoi në veçanti ekipin e vëzhgueseve amerikanë të EUCOM për vlerësimin e dhënë për instruktorët EOD të Qendrës Stërvitore në Komandën Mbështetëse dhe atyre të FSK-së.

Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët. Në kurs morën pjesë 13 vetë, 10 kursantë nga FA (kryesisht Batalioni I Xhenios) dhe 3 kursantë nga FS Kosovë.

Batalioni i Xhenios (bXh)

Përfundon Kursi i Urave "Bailey"

Në ambientet e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios (bXh), u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Urave "Bailey", kurs drejtuar nga instruktorët e Qendrës Stërvitore. Në këtë ceremoni nderuan me pjesëmarrjen e tyre zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, komandantët e Qendrës Stërvitore dhe të Batalionit të Xhenios si dhe efektivë të këtyre reparteve. Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse përshëndeti dhe u uroi kursantëve të sapo diplomuar suksese në këtë trajnim kaq të rëndësishëm, i cili ndihmon në përmbushjen e misionit dhe efikasitetit të kësaj kompanie, për t'i ardhur në ndihmë komunitetit në çdo kohë. Major Arben Rira, komandant i Togës së Urave theksoi se ky kurs, i pari i zhvilluar deri më tani, është mjaft i vlefshëm për gërshtimin në praktikë për realizimin e të gjitha llojeve të urave që realizohen në terren duke parë dhe kapacitetet në tonazh që ura duhet të ketë në rast kërkesash. Urat "Bailey" vitet e fundit kanë qenë shumë të kërkuara nga pushteti lokal për mbështetjen e komunitetit civil, pasi janë tepër të përshtatshme për terrenet e thyera të zonave të thella rurale.



Gjeneral brigade Kollçaku në Qendrën e Kontroll-Raportimit

Zhvillohet stërvitja ajrore “Tango Scramble”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku zhvilloi një vizitë në Qendrën e Kontroll-Raportimit (QKR) të Forcës Ajrore.

Qëllimi i vizitës ishte ndjekja e stërvitjes “Tango Scramble”, e cila zhvillohet në kuadër të realizimit të misionit të policimit ajror, në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me CAOC-Torrejon, Spanjë.

Në fluturimin stërvitor “Tango Scramble”, morën pjesë 3 avionë ushtarakë Tip M-2000 të NATO-s. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Kollçaku u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Editson Zarka.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nëpërmjet një brifingu të dhënë nga shtabi i Forcës Ajrore dhe komandanti i Qendrës së Kontroll-Raportimit nënkolonel Sulo Mustafaraj, u njoh me historikun dhe me skenarin konkret të kësaj stërvitjeje. Më tej u ndoq fluturimi në lartësi të ulët mbi aeroportin e Rinasit. Në përfundim, gjeneral brigade Kollçaku falënderoi personelin e QKR për angazhimin në stërvitje dhe nivelin e përgatitjes së tyre dhe shprehu vlerësime për shtabin e Forcës Ajrore në koordinimin me strukturat e NATO, për

“ Në fluturimin stërvitor “Tango Scramble”, morën pjesë 3 avionë ushtarakë Tip M-2000 të NATO-s

zhvillimin e stërvitjeve të tilla.

Ndër të tjera, gjeneral brigade Kollçaku shprehu mbështetjen e vazhdueshme të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes në implementimin e projekteve

për modernizimit e Qendrës së Kontroll-Raportimit, si dhe në trajnimin e personelit të saj në interes të rritjes së operabilitetit për realizimin e detyrave që rrjedhin nga misioni.

FORCA TOKËSORE

Zhvillohet kursi i mjeteve të blinduara HMMWV

Në sallën e konferencave të Forcës Tokësore (FT), u zhvillua ceremonia e përfundimit të trajnimit të mirëmbajtjes së mjeteve të blinduara tip HMMWV. Në ceremoni morën pjesë: komandanti i Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore (QSFT), shefi i Zyrës Amerikane për Bashkëpunim Usharak (ODC) zëvendëskomandanti i Batalionit II të Këmbësorisë (b2k), grupi i instruktorëve amerikanë nga Njësia e Lëvizshme e Mirëmbajtjes së Pajisjeve etj. Komandanti i Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore, duke përshëndetur pjesëmarrësit, e vlerësoi këtë trajnim si aktivitet i një rëndësie të veçantë, që ka impakt të jashtëzakonshëm në rritjen profesionale të efektivëve ushtarakë shqiptarë, të cilët janë të angazhuar çdo ditë gjatë punës së tyre, në përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të këtij lloji.

“Përfitoj nga rasti që nëpërmjet shefit të Zyrës Amerikane për Bashkëpunim Usharak, të përcjell në emër të komandantit të Forcës Tokësore, falënderimet dhe mirënjohjen e veçantë për mikun dhe aleatin tonë strategjik në NATO, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për këtë trajnim, i cili vjen në vijimësi të një numri të shumtë trajnimesh, me të cilat qeveria dhe ushtria amerikane kanë mbështetur prej vitesh tashmë Forcat e Armatosura shq-

Në Qendrën e Simulimit zhvillohet stërvitja “Balkan Bridge-19”

Në kuadër të Iniciativës së Shefave të Shtabeve për Ballkanin, si dhe të rrjetit të trajnimit dhe stërvitjeve për vendet e Europës juglindore, që shërben si media për komunikim, shkëmbim të dhënash dhe sjellje operative të simuluar, u zhvillua në Qendrën e Simulimit, egzekutimi i stërvitjes simuluese “Balkan Bridge-19”. BB19 është vijim i stërvitjeve të mëparshme “SEESIM”, “Flaka e Energjisë 11”, “Phoenix 10”, etj. Në këtë stërvitje morën pjesë: Komanda e Forcës së Bashkuar Bullgari dhe Qendra e Trajnimit dhe Simulimit Bullgari, Komanda e Trajnimit të NATO-s, për stërvitjen Bydgoszcz Poloni, vendet si: Shqipëri, Serbi, Kroaci, Greqi, Turqi, Rumani, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut luajnë nga Qendra e Simulimit Charilitsa Bullgari. Stërvitja u drejtua nga Komanda e Forcës së Bashkuar, Bullgari. Për herë të parë në këtë stërvitje përfshihej edhe SEEBRIG si një audience primare e trajnimit.

Nga FARSH morën pjesë në këtë stërvitje KFT me një kompani të batalionit të dytë, një kompani xhenjo dhe Policisë Ushtarake. Çdo kompani vlerësohej nga grupi i vlerësimit me personel nga Qendra e Simulimit.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje, është



Në këtë stërvitje morën pjesë: Shqipëria, Bullgaria, Serbia, Kroacia, Greqia, Turqia, Rumania, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, brigade SEEBRIG dhe Komanda e Trajnimit të NATO-s, për stërvitjen Bydgoszcz-Poloni



një ushtrim i asistuar me kompjuter CAX, në nivel taktik që do të trajnojë dhe ushtrorë shtabet dhe njësitë pjesëmarrëse në kryerjen e Operacionit për Mbështetjen e Paqes në koordinim me pjesën tjetër të partnerëve rajonalë, si pjesë e forcës më

të madhe të udhëhequr nga NATO-ja, në një mjedis kompleks civilo-ushtarak, e që paraqesin incidente luftarake me intensitet të ulët.

Objektivat e saj ishin: trajnimi dhe ushtrimi i pjesëmarrësve për të përbushur sfidat e reagimit shumëdimensional aktuale dhe ato të ardhshme në përgjigje të krizave dhe operacioneve të paqes; përmirësimi i asftësive të shtabit të brigadës shumëkombëshe për të ushtruar Komandim-Kontrollin (C2) mbi një forcë të kombinuar në një operacion më të madh të NATO-s në një mjedis të përbashkët shumëkombësh; përdorimi i procedurave të NATO-s në planifikimin, operacionet dhe raportimin midis vendeve pjesëmarrëse brenda shtabit të Brigadës Shumëkombëshe; testimi dhe zhvillimi i rrjetit të trajnimit dhe stërvitjeve për vendet e Europës juglindore (SEEETN); harmonizimi i procedurave midis vendeve pjesëmarrëse në fushën e paqeruajtjes; promovimi i bashkëpunimit rajonal; promovimi i mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis të gjitha vendeve, forcave, organizatave, agjencive dhe personelit pjesëmarrës; praktikimi dhe përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit/menaxhimi i informacionit ndërmjet pjesëmarrësve, etj.



iptare” - tha ndër të tjera në fjalën e tij komandanti i Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore. Nga ana e tij, zëvendëskomandanti i b2k, e vlerësoi trajnimin e efektivëve që ai drejton si tepër të nevojshëm, duke qenë se Batalioni i Dytë i Këmbërorisë, si bërthama e Grup Batalionit të Lehtë të Këmbërorisë, i ka mjetet HMMWV pjesë e organikës së tij. Sipas zëvendëskomandanti të b2k, njohuritë e marra nga efektivat, pjesëmarrës në këtë trajnim, do të rrisin edhe më tej profesionalizmin dhe nivelin e gatishmërisë profesionale të këtij batalioni. Në kursin, për mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara tip HMMWV, morën pjesë 20 ushtarakë nga forcat dhe repartet e Forcave të Armatosura. Përgatitja e tyre, u krye nga instruktorët amerikanë të Njësisë së Lëvizshme të Mirëmbajtjes së Pajisjeve për një periudhë një mujore.

Ambasadori i Italisë z. Alberto Cutillo në Komandën e Doktrinës

“Perspektiva italiane dhe zhvillimet aktuale të Europës juglindore”

Bashkëpunim
me Qendrën
për Studimet
e Larta të
Sigurisë së
Forcave të
Armatosura
Italiane

Paraditën e datës 10 tetor 2019, komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, priti në një takim të vecantë Ambasadorin e Italisë në Shqipëri, Zotin Alberto Cutillo. Në takim morën pjesë atashëu ushtarak italian i akredituar në vendin tonë Kolonel Fabio Cornacchia, i cili shoqëronte Ambasadorin Cutillo, si dhe Shefi i Seksionit të Grupit të Studimeve Strategjike, Kolonel Vullnet Doka.

Pasi i uroi mirëseardhjen, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, e njohu Ambasadorin e Italisë në Shqipëri, Zotin Alberto Cutillo, me përshkrimin e KLSM, si kursi më i lartë institucional në fushën e sigurisë e mbrojtjes në sistemin arsimor ushtarak; vëmëndjen e MM dhe SHP për arritjen e objektivit madhor të këtij kursi, në funksion të aspirimit për kalimin në fazën tjetër të akreditimit nga NATO.

Gjeneral Begaj, theksoi rëndësinë e misionit të këtij kursi, i cili ka të bëjë me edukimin dhe përgatitjen në nivelin politiko-strategjik të oficerëve me gradën kolonel dhe civilëve ekuivalent, nga Forcat e Armatosura dhe Institucionet e Sigurisë të Republikës së Shqipërisë dhe vendet e

rajonit, në kuadër të forcimit e rritjes së bashkëpunimit rajonal e më gjërë në fushën e mbrojtjes.

Gjithashtu, Zoti Cutillo, u njoh me kurrikulat e mësimdhënies, përmirësimet e bëra, audiencën e pjesëmarrjes në kurs, në mënyrë të vecantë për audiencën e huaj nga vendet e rajonit.

Gjeneral Begaj, u ndal në rëndësinë e bashkëpunimit midis të dy vendeve, duke theksuar se ky b/punim, i nisur më parë do të vazhdojë të thellohet më shumë dhe në të ardhmen, duke shtuar dhe fushat e bashkëpunimit.

Gjeneral Begaj, falenderoi Ambasadorin Cutillo për krijimin e mundësive për bashkëpunimin me Qendrën për Studimet e Larta të Sigurisë së Forcave të Armatosura Italiane (CASD), Qendrën e Bashkuar Operative të FA Italiane (COI), si dhe NATO Defence College.

Nga ana e tij, Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Zoti Alberto Cutillo, u shpreh tepër entuziast për frymën dhe rritjen e këtij bashkëpunimi. Ai vlerësoi bashkëpunimin dypalësh, por nga ana tjetër vlerësoi mjaft pozitivisht dhe bashkëpunimin dhe kooperimin midis pjesëmarrësve shqiptarë dhe atyre të huaj në Kursin e Lartë të Sigurisë, duke u shprehur se ky b/punim do i shërbejë më së miri ndarjes së ideve, shkëmbimit të eksperiencave për çështje të ndryshme, të fokusuara kryesisht në fushën e sigurisë e mbrojtjes, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për vendet e rajonit.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit shprehën bindjen se marrëdhëniet dhe b/punimi dypalësh në fushën e arsimimit dhe trajnimit, do të vazhdojnë të thellohen më tej.

Në kontekstin e këtij takimi ishte dhe tematika që Ambasadori i Italisë Alberto Cutillo, zhvilloi me audiencën e KLSM, “Perspektiva italiane dhe zhvillimet aktuale të Europës juglindore”. Lektimi i Ambasadorit Cutillo, u përcoll me interesim të veçantë nga kursantët e Kursit të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke u shoqëruar me pyetje e diskutime të ndërsjellta.



Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, priti në një takim të vecantë Ambasadorin e Turqisë në Shqipëri, Zotin Murat Yoruk. Ambasadori Yoruk, në këtë takim shoqërohej nga zv/atasheu ushtarak turk i akredituar në vendin tonë, Kapiten Ali Atalay.

Pasi i uroi mirëseardhjen, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, e njohu zotin Yoruk me përshkrimin e Kursit të Lartë të Sigurisë, me ecurinë e zhvillimit të tij në kuadër të rritjes së bashkëpunimit rajonal e më gjërë në fushën e mbrojtjes. Gjeneral Begaj, u ndal në rëndësinë e bashkëpunimit midis të dy vendeve në fushën e arsimit dhe trajnimit ushtarak. Në këtë kontekst, Gjeneral Begaj, e falenderoi ambasadorin Yoruk, dhe nëpërmjet tij shtetin turk për krijimin e mundësisve dhe ofrimin e mbështetjes së gjithanshme për trajnimin e kursantëve e kadetëve shqiptarë në institucionet arsimore ushtarake turke. Gjithashtu, edhe për krijimin e urave të ngushta të bashkëpunimit, në drejtim të shkëm-

“Vizioni turk mbi zhvillimet në Ballkanin Perëndimor...”



bimit të lektorëve dhe eksperiencave dypalëshe. Nga ana e tij, ambasadori Yoruk shprehu gadishmërinë e tij, për të ofruar cdo lloj mbështetje të mundshme, në kuadër të forcimit dhe ecurisë pozitive të bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe asaj dypalëshe.

Pas takimit, Ambasadori i Turqisë në Shqipëri, zoti Murat Yoruk, zhvilloi me Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, lektimin “Vizioni turk mbi zhvillimet më të fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”.

Ambasadori i Mbretërisë, Norman, në KDS

Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, priti në një takim të vecantë Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, Zotin Duncan Norman. Takimi ishte në kuadër të lektimit si “Guest Speaker” që Ambasadori britanik Norman, do të zhvillojë me Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes, sipas programit të miratuar.

Në takim morën pjesë Zv/Komandanti i KDS Kolonel Dilaver Hoxha, Zv/Komandanti /Rektori i AFA, Kolonel Edmond Braneshi, si dhe Shefi i Seksionit të Grupit të Studimeve Strategjike, Kolonel Vullnet Dokaj. Ambasadori Norman, në këtë takim shoqërohej nga atasheu ushtarak britanik i akredituar në vendin tonë, Kolonel Christooher Mayoocl.

Pasi i uroi mirëseardhjen, Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, e njohu Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, Zotin Duncan Norman, me përshkrimin e KLSM, si kursi më i lartë institucional në fushën e sigurisë e mbrojtjes në sistemin arsimor ushtarak; vëmëndjen e MM dhe SHP për arritjen e objektivit madhor të këtij kursi, në funksion të aspirimit për kalimin në fazën tjetër të akreditimit nga NATO. Gjeneral Begaj, theksoi rëndësinë e misionit të këtij kursi, i cili ka të bëjë me

Marrëdhëniet në fushën e arsimit do të thellohen më tej

edukimin dhe përgatitjen në nivelin politiko-strategjik të oficerëve me gradën kolonel dhe civilëve ekuivalent, nga Forcat e Armatosura dhe Institucionet e Sigurisë të Republikës së Shqipërisë dhe vendet e rajonit, në kuadër të forcimit e rritjes së bashkëpunimit rajonal e më gjërë në fushën e mbrojtjes.

Gjithashtu, Zoti Norman, u njoh me kurrikulat e mësimdhënies, përmirësimet e bëra, audiencën e pjesëmarrjes në kurs, në mënyrë të vecantë për audiencën e huaj nga vendet e rajonit. Gjeneral Begaj, u ndal në rëndësinë e bashkëpunimit midis të dy vendeve, kryesisht me Qendrën e Zhvillimit dhe Stërvitjes Ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, në drejtim të ofrimit të eksperiencës së ushtrisë britanike nëpërmjet bashkëpunimeve që parashikohen në të ardhmen me Akademinë tonë të Nënoficerëve, në funksion të trajnimit të instruktorëve të ANO-së, veçanërisht trupës së instruktorëve që zhvillojnë Kursin e Instruktorit, identifikimit të fushave të bash-

këpunimit për çështjet gjuhësore dhe nevojave përkatëse ku mund të asistojë pala britanike.

Gjeneral Begaj, shprehu mirënjohje edhe për qeverinë angleze në drejtim të mbështetjes dhe bashkëpunimit ndër vite, që është bërë konkretisht për Qendrën e Gjuhëve të Huaja, në drejtim të trajnimit të personelit ushtarak në gjuhën angleze, si dhe për mbështetjen me bazë materiale. Gjeneral Begaj, edhe njëherë mbështeti idenë e vijueshmërisë së këtij bashkëpunimi, për ta bërë sa më interaktive dhe interesante mësimin e gjuhës angleze për të gjitha nivelet, që nga ushtari deri tek niveli i komandantit

Nga ana e tij, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, zoti Duncan Norman, u shpreh tepër entuziast për frymën dhe rritjen e këtij bashkëpunimi. Ai e vlerësoi këtë bashkëpunim si një eksperiencë mjaft frytdhënëse. Në fund të takimit, bashkëbiseduesit shprehën bindjen se marrëdhëniet e b/punimi dypalësh në fushën e arsimit dhe trajnimit, do të vazhdojnë të thellohen më tej.



Programi "Team Working"

KLS: Vizitë në Sazan, Pashaliman, Butrint dhe Gjirokastër

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes në kuadër të programit akademik realizoi një vizitë dy ditore mësimore në Jug të Shqipërisë.

Qëllimi i vizitës ishte njohja me rëndësinë gjeo-strategjike të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, njohja me vendet historike e kulturore të vendit tonë, në mënyrë të veçantë për pjesëmarrësit nga vendet partnere, si dhe zhvillimi i programit "Team Working" me pjesëmarrësit në KLSM 2019. Pjesë e programit ishte edhe vizita në Bazën e Pashalimanit, udhëtimi me anije në ishullin e Sazanit, udhëtim në qytetin e Sarandës dhe Parkun Kombëtar të Butrintit, si dhe vizitë në kalanë e Gjirokastrës.

Gjatë udhëtimit me anije për në Bazën e Sazanit, zëvendëskomandanti i Forcës Detare Kapiten i Rangut të I Artur Meçollari, i njohu pjesëmarrësit në KLSM me rëndësinë gjeo-strategjike të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, si dhe i njohu me zhvillimet historike dhe rolin që ka luajtur Ishulli i Sazanit, Baza e Pashalimanit dhe baza të tjera në jugperëndim të Shqipërisë gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Në vijim, nga ana e komandantit të anijës "Butrinti", në prani të zëvendëskomandantit të Forcës Detare u brifua për misionin, de-

tyrat, organizmin dhe zhvillimet e Forcës Detare dhe Flotiljes Detare të Jugut, si dhe kontributin që personeli i Flotiljes dhe Forcës Detare jep në kuadër të misionit të NATO-s në detin Egje.

Pas vizitës së Bazës së Sazanit pjesëmarrësit udhëtuan për në Bazën e Pashalimantit, ku u pritën në takim nga Komandanti i Bazës, Kapiten i Rangut të I Adnand Agastra, i cili me anë të një brifingu prezantoi misionin, detyrat dhe aktualitetin e kësaj baze. Gjatë vizitës, nga efektivë të Flotiljes dhe Policisë

Ushtarake, të cilët ishin në proces stërvitor, u bë një demonstrim i shkurtër për mënyrën e veprimit të grupit të bordingut në operacione të ndërhyrjes detare.

Nëpërmjet vizitës kulturore në Parkun Kombëtar të Butrintit dhe qytetin e Gjirokastrës, pjesëmarrësit në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes u njohën me trashëgiminë e pasur kulturore dhe historike të vendit tonë, duke i shërbyer njohjes së vlerave të vendit tonë nga pjesëmarrësit e huaj.



Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes vizitë në Bruksel

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), i kryesuar nga Komandanti i KDS Gjeneral Brigade, Prof. Asoc. Bajram Begaj, zhvilloi vizitë mësimore dy ditore në Komandën Strategjike të Aleancës për Operacionet (SHAPE), Mons, Selinë e NATO-s, Bruksel, si dhe në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Mbretërisë së Belgjikës.

Qëllimi i vizitës ishte njohja e kursantëve me institucionet ndërkombëtare të sigurisë, rolin, misionin, dhe detyrat e Komandës Strategjike të Aleancës për Operacionet, sfidat e transformimit dhe adoptimit me strukturën e re, operacionet aktuale të NATO-s, partneritetet ushtarake, prioritetet kyçe të NATO-s, si dhe me planet e zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Belgjikës.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM) u prit nga Përfaqësuesi Ushtarak i Shqipërisë në SHAPE, Kolonel Petrit Çuni, dhe më pas vijoi me takimin zyrtar në Komandën Strategjike të Aleancës për Operacionet (SHAPE), Mons, ku u pritën nga Gjeneral Markus Kneip, Shef i Shtabit i SHAPE. Gjeneral Kneip, vlerësoi vizitën dhe faktin që Shqipëria organizon një kurs me pjesëmarrje nga Shqipëria, vendet e rajonit, vendet e NATO-s dhe partnere, si dhe nga institucionet civile. Gjeneral Kneip, duke prezantuar misionin dhe rolin që SHAPE luan



Gjeneral Markus Kneip, Shef i Shtabit i SHAPE: “Sfidat e sigurisë janë gjithëpërfshirëse, përballimi i të cilave kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të shumë aktorëve”



si një komandë, duke u fokusuar në komandim-kontrollin, planifikimin e mbrojtjes, trajnimin, dhe marrëdhëniet me partnerët. vuri në dukje edhe se sfidat e sigurisë sot janë gjithëpërfshirëse, përballimi i të cilave kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të shumë aktorëve, që ky kurs e reflekton në mënyrën më të mirë. Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, falënderoi Gjeneral Kneip për mikpritjen që i bëri KLSM dhe vlerësoi rolin që Komanda Strategjike e Aleancës për Operacionet luan në garantimin e paqes dhe stabilitetit në rajon e më gjerë. Gjithashtu, Gjeneral Begaj, bëri një

panoramë të kursit KLSM, kurrikulës si dhe theksoi rëndësinë që ka vizita në SHAPE e këtij kursi, për të parë nga afër zhvillimet strategjike dhe operacionale të NATO-s.

Në prezantimet zyrtare, pjesëmarrësit u njohën me operacionet aktuale të NATO-s, me marrëdhëniet e partneritetit të NATO-s, sfidat e transformimit, si dhe me rolin, misionin dhe detyrat e Qendrës së Menaxhimit të Krizëve dhe Operacioneve në SHAPE.

Ditën e dytë KLSM zhvilloi vizitë në selinë e NATO-s, ku u njohën me prioritetet kyçe të NATO-s, Politikat e Mbrojtjes dhe Planëzimit në NATO, Planet dhe Operacionet aktuale të NATO-s, si dhe Sfidat e reja të Sigurisë ndaj Aleancës. Gjatë kësaj vizite u zhvillua një takim edhe me Ambasadorin e Shqipërisë në NATO, Zoti Visho Ajazi dhe Përfaqësuesin Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në NATO, Gjeneral Major Nazmi Cahani, në të cilën pjesëmarrësit u njohën me rolin dhe kontributin e Shqipërisë në operacionet e NATO-s dhe me gjerë.

Pjesë e programit ishte edhe vizita në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Mbretërisë së Belgjikës, ku në takimet e zhvilluara pjesëmarrësit u njohën me Politikat e Mbrojtjes së Belgjikës dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, roli që luan Belgjika si kryesuese e Këshillit të Sigurimit të OKB për vitin 2019-2020, si dhe me planet e zhvillimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Belgjikës.

Kolonel Fatmir Loka, Komandanti i ri i ANO-s

Në ambjentet e Akademisë së Nënoficerëve në prani të Komandantit të KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, personelit ushtarak e civil të akademisë, u bë prezantimi i Komandantit të ri të ANO, Kolonel Fatmir Loka.

Komandanti i KDS, Gjeneral Brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj shprehu konsideratën për punën dhe përkushtimin në detyrë të kolonel Fatmir Loka, të sapoemëruar në detyrën e komandantit të ANO, si një ushtarak me eksperiencë të gjatë në shume detyra, duke theksuar se karriera dhe eksperiencia e tij do t'i japë një shtysë të re punës së deritanishme në ANO dhe formatimit dhe modernizimit të saj. Më pas ai i uroi atij suksese në detyrë si edhe i garantoi mbështetjen për kryerjen e detyrave në krye të ANO. Kolonel Fatmir Loka emërohet në këtë detyrë pas një karriere të suksesshme në Forcat e Armatosura.

Nënkolonel Christopher Maycock në Komandën Mbështetëse

Bashkëpunim me Britaninë e Madhe në fushën e logjistikës

“Arsimim, trajnim, mbështetje me materiale teknike dhe stërvitje të përbashkëta”

Atasheu ushtarak i Britanisë së Madhe i akredituar në Tiranë, nënkolonel Christopher Maycock, zhvilloi më 24 tetor një vizitë kortezie në Komandën Mbështetëse, ku u prit nga komandanti i kësaj komande gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku. Qëllimi i vizitës ishte njohja më nga afër me misionin, rolin e Komandës Mbështetëse në Forcat e Armatosura si dhe rritjen e bashkëpunimit midis dy shteteve në fushën e Mbrojtjes. Gjeneral brigade Sallaku duke i shprehur mirëseardhjen nënkolonel Maycock në këtë komandë, i uroi atij njëkohësisht suksese në detyrën e tij të re dhe të rëndësishme. Gjatë takimit, ushtarakët e dy vendeve evidentuan fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcat e Armatosura të Britanisë së Madhe, që nga arsimimi e trajnimi i ushtarakëve shqiptarë në fushën e Logjistikës, mbështetjen konkrete me

materiale teknike dhe deri tek stërvitjet e përbashkëta midis dy vendeve të zhvilluara ndër vite. Komandanti i Komandës Mbështetëse duke vlerësuar vizitën e nënkolonel Maycock, shprehu në të njëjtën kohë edhe besimin e tij se bashkëpunimi dypalësh do të bëhet edhe më i ngushtë edhe më i frytshëm, sidomos në fushën e trajnimit dhe edukimit të ushtarakëve të Komandës Mbështetëse në fushën e Logjistikës.

Nga ana e tij, nënkolonel Maycock shprehu bindjen se fusha të reja bashkëpunimi do të hapen mes dy vendeve në të ardhmen dhe se marrëdhëniet do të thellohen më tej, bashkëpunimi ushtarak ndërmjet dy vendeve tona do të vazhdojë të jetë në nivele të larta si dhe do të njohë rritje në të gjitha fushat me interes reciprok. Në përfundim të takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën gatishmërinë për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.



Në ditën e parë të muajit tetor, specialistët e Batalionit të Xhenios (bXH) të Komandës Mbështetëse filluan operacionin i cili zgjati disa ditë, për asgjësimin e një masivi shkëmbor, shumë pranë autostradës "Rruga e Kombit", në segmentin rrugor, Milot-Morinë, Bashkia Kurbin, i cili si pasojë e lëkundjeve të forta të tërmetit të muajit shtator, si dhe gërryerjes nga reshjet e dendura në këtë zonë, ka bërë që ky masiv të rrezikojë seriozisht, jo vetëm qarkullimin e automjeteve në këtë segment, por edhe linjën e tensionit të lartë Shkopet-Ulzë. Nga bXH në këtë operacion u angazhuan 10 specialistë, 2 mjete, si dhe 1 agregat. Pas një studimi që specialistët xhenierë në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave në Bashkinë Kurbin, i bënë zonës, u morën të gjitha masat dhe u vendos që shkatërrimi i masivit shkëmbor me një vëllim rreth 200 m³, të bëhej me shpërthim të kontrolluar, me qëllim ruajtjen nga dëmtimit të autostradës si dhe linjën e tensionit të lartpërmendur, e cila kalon shumë pranë këtij masivi shkëmbor. Edhe pse në kushte jo të favorshme terreni (terreni tepër

Asgjësohet masivi shkëmbor në segmentin rrugor Milot-Morinë



i thyer), specialistet e Kompanisë së Ndërtimeve të bXH punuan intensivisht për finalizimin me sukses të këtij operacioni sensitiv, i cili

ishte i një rëndësie të veçantë për kontributin për sigurinë e kësaj rruge dhe eliminimin e rreziqeve të lartpërmendura.

KOMPANIA EOD-BATALIONI I XHENIOS

Specialistët e kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse, u angazhuan më datë 12 tetor 2019 në një operacion tepër sensitiv për vlerësimin, çaktivizimin dhe transportimin e një arsenali predhash prej 100-120 mm, të gjetura në fshatin Shetaj të njësisë administrative Ishëm, bashkia Durrës. Këto predha u gjetën gjatë punimeve të kryera për ndërtimin e një depo uji nga bashkia Durrës, shumë pranë shtëpive të këtij fshati.

Pas vlerësimit në vendngjarje, deri më tani janë zbuluar 40 predha, të cilat konsiderohen të rrezikshme për jetën e banorëve. Pesë nga këto predha janë transportuar në Batalionin e Xhenios për asgjësim në poligonin e rajonit të Bizës. Predhat kanë një peshë përafërsisht 30 kg dhe i përkasin trazirave të vitit 1997. Në këtë operacion morën pjesë 5 specialistë EOD nga Bata-

Asgjësohen 40 predha, 100-120 mm në Ishëm të Durrësit



lioni i Xhenios, të mbështetur nga Policia Ushtarake, Policia e Rendit si dhe specialistë të prefekturës së Durrësit. Grupi EOD ndodhet aktualisht në vendngjarje dhe vazhdon operacionin për vlerësimin e

pjesës së mbetur të predhave, si dhe kontrollin e të gjithë perimetrit të zonës ku mendohet se mund të ketë dhe predha të tjera, me qëllim asgjësimin e tyre dhe eliminimin e rrezikut për banorët përreth.

Policia Ushtarake trajnohet nga Karabinieria Italiane

Efektivët e Policisë Ushtarake janë trajnuar nga ekspertët e Armës së Karabinierisë Italiane (Arma dei Carabinieri). Ky trajnim vjen si pasojë e një bashkëpunimi të shkëlqyer ndër vite midis Policisë Ushtarake të FA të Republikës së Shqipërisë dhe Karabinierisë Italiane. Stërviçja, e cila për herë të parë zgjati tre javë, përgatiti 30 efektivë të PU-së për stërviçje më komplekse përse i përket qitjes operative. Qëllimi i kësaj stërviçjeje është aftësimi i trupës për përdorimin e armëve të gjata dhe të shkurtra. Me rastin e përfundimit të stërviçjes toga e PU demonstroi ushtrime komplekse për përdorimin e armëve në qitje operative. Ky demonstrim u ndoq nga atashëu ushtarak i Italisë kolonel Fabio Cornacchia dhe komandanti i Policisë Ushtarake kolonel Altin Kurti.

Në përfundim të ushtrimit komandanti i PU kolonel Kurti shpërn-

Stërviçja zgjati tre javë dhe u përgatitën 30 efektivë të PU-së, në stërviçje komplekse me qitje operative



dau certifikata për instruktorët italianë: Maresciallo Massimo Vicini, Brigadiere Capo Nicola Fasano, Appuntato Scelto Qs. Giuseppe D'Anna. Vlen për t'u theksuar se bashkëpunimi bilateral midis Policisë Ushtarake të FARSH dhe Karabinierisë Italiane daton që nga krijimi i PU, e cila pati një rritje të

jashtëzakonshme mbi bazën e një projekti me Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE). Batalioni i PU në Tiranë u krijua me ndihmën e specialistëve italianë, ku u kompletua me bazën materiale e logjistike të nevojshme dhe u konceptua sipas modelit të batalioneve të Arma dei Carabinieri.

21-VJETORI I KRIJIMIT

Batalioni i Forcave Speciale strukturë e rëndësishme e FA

Umbajt më 18 tetor ceremonia e kremtimit të 21-Vjetorit të Krijimit të Batalionit të Forcave Speciale. Në këtë aktivitet, mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, administratori i njësive administrative Zall-Herr Arben Maloku, përfaqësues nga shtabi i Forcës Tokësore, komandantë repartesh, ish-pjesëtarë të bFS, familjarë të efektivëve të këtij batalioni si dhe nxënës nga shkolla e mesme.

Në këtë aktivitet të gjithë pjesëmarrësit patën mundësi të ndiqnin nga afër demonstrimet dhe veprimet luftarake si: luftim i afërt, qitje me precesioni, qitje e alternuar, testim stresi gjatë qitjes si dhe të shihnin

“Kjo njësi nuk do të ishte pa ndihmën e partnerëve tanë strategjikë dhe në mënyrë të veçantë të SHBA-së”

teknikën e armatimit të këtij batalioni nëpërmjet ekspozitës statike të vendosura enkas për të ftuarit.

Fjalën e hapjes në këtë ceremoni e mbajti komandanti i bFS, nënkolonel Ramadan Karakushi, i cili përgëzoi çdo efektiv për punën e palodhur ndër vite, duke ngritur sa më lart emrin e këtij batalioni dhe FA në tërësi. Komandanti i Forcës Tokësore, në fjalën e tij përshëndetëse përgëzoi përkushtimin, profesionalizmin, ndjenjën e lartë të përgjegjësisë që kjo njësi ka treguar ndër vite duke përfaqësuar vlerat më të mira të FA, kauzës për të cilën ju

shërbeni ndaj vendit, aleatëve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë. Kjo njësi nuk do të ishte më sot, pa ndihmën e partnerëve tanë strategjikë dhe në mënyrë të veçantë SHBA, të cilët kanë rritur dhe përmirësuar kapacitetet operacionale luftarake, falë mbështetjes me instruktorë të FS në fushën e trajnimit të shtabit dhe trupave para dislokimit në zonat e rrezikut, si dhe në operacionet direkte luftarake në Afganistan. Në përfundim të kësaj ceremonie, të gjithë të ftuarit morën pjesë në koktejin e organizuar për këtë aktivitet.

Batalioni i Mbështetjes me Luftim i Forcës Tokësore (bM-LFT), kremtoi më 1 tetor 2019, ditën e sotme 5-Vjetorin e krijimit të tij. Ceremoninë e rastit, e nderoi me prezencën e tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, përfaqësues nga shtabi i Forcës Tokësore, etj.

Fjalën e hapjes, e mbajti komandanti i bML nënkolonel Lavdrim Oshafi, i cili pasi bëri një rezymë të krijimit të repartit që ai drejton, ndër të tjera renditi edhe arritjet e këtyre efektivave gjatë këtyre 5 viteve. Më tej, nënkolonel Oshafi vazhdoi fjalën e tij duke theksuar objektivat që e presin në të ardhmen këtë batalion, ku modernizimi do të jetë kryefjala e aktivitetit të tij në të ardhmen. Ai e mbylli fjalën e tij përshëndetëse me rastin e 5-Vjetorit të krijimit të repartit, me premtimin se ky batalion në vitet në vijim, do t'i realizojë programet e stërvitjes me disiplinë dhe profesionalizëm të lartë, duke qenë në gatishmëri të plotë, për realizimin e çdo detyre dhe misionit të ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, duke marrë fjalën për të përshëndetur ceremoninë, fillimisht shprehu kënaqësinë për prezencën e tij në këtë ditë të shënuar jo vetë për efektivat e bML, por për mbarë Forcat e Armatosura.

5-Vite nga krijimi i Batalionit të Mbështetjes me Luftim

Batalioni i Mbështetjes me Luftim, u krijua me 1 tetor 2014, si rezultat i ristrukturimit të Forcave të Armatosura dhe si domosdoshmëri e misionit të Forcës Tokësore



“ ... Edhe pse Batalioni i Mbështetjes me Luftim është një batalion i ri në moshë, ka ditur që këta 5 vjet të krijimit të tij të përballojë shumë sfida, dhe të tregojë se është e aftë t'i përgjigjet dhe të përmbushë me sukses çdo detyrë të ngarkuar. Puna, mundi dhe djersa juaj e këtyre viteve, në shërbim të atdheut është vlerësuar dhe ka gjetur mirënjohjen jo vetëm të lidërshiptit ushtarak të Shtabit të Përgjithshëm dhe Forcës Tokësore ku ju bëni pjesë, por gjithashtu edhe të lidërshiptit civil të Ministrisë së

Mbrojtjes. Asetet tuaja të çmuara siç janë Kompania e Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë, Bateria e Mortajave dhe kompania e Xhenios, çdo ditë të punës së tyre na kanë bërë të ndihemi krenarë. E gëzofshi 5 - Vjetorin e krijimit! Festofshi edhe shumë përvjetorë të tjerë!” - tha ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku. Batalioni i Mbështetjes me Luftim, u krijua me 1 tetor 2014 si rezultat i ristrukturimit të Forcave të Armatosura dhe si domosdoshmëri e misionit të Forcës Tokësore.

Forca Tokësore

“**M**nela-19” ishte kodi i stërvitjes së radhës së zhvilluar nga data 14-23 tetor nga efektivat e Batalionit të Parë të Këmbëtorisë së Forcës Tokësore. “Mnela-19” kishte si qëllim kompaktësimin e veprimëve të batalionit në operacionet e mbështetjes së paqes dhe stabilitetit. Stërvitja kishte si objektiva të saj rritjen e nivelit të planëzimit dhe zhvillimit të stërvitjes me kualitet të lartë, në përputhje me doktrinën dhe standardet e NATO për të përmirësuar gatishmërinë e nën reparteve dhe aftësinë drejtuese në realizimin e operacioneve të mbështetjes së paqes. Gjatë kësaj stërvitje, efektivet e batalionit ndëruan fushën

Batalioni i Parë i Këmbëtorisë zhvillon stërvitjen “Mnela-19”

e futbollit të shkollës 9-vjeçare “Mnelë”, ndihmuan në sistemimin e mjediseve rrethuese të saj si dhe zhvilluan një koktej të vogël për nxënësit e shkollës, ku shpërndanë dhe disa dhurata simbolike me kontributin e efektivit të batalionit.

Nga i gjithë efektivi i Batalionit të Parë të Këmbëtorisë pati angazhim dhe përkushtim maksimal për realizimin e çdo detyre të ngarkuar. Një punë mjaft e mirë u bë edhe nga ana e shtabit të këtij batalioni në

drejtim të planëzimit dhe organizimit të stërvitjes. Kjo stërvitje u ndoq, kontrollua dhe këshillua në çdo hap të saj nga komandanti i batalionit nënkolonel Ali Mali, i cili në përfundim të stërvitjes falënderoi të gjithë efektivat e angazhuar në stërvitjen “Mnela 2019” për përkushtimin, disiplinën dhe profesionalizmin e treguar. Nënkolonel Mali i inkurajoi trupat që të njëjtin përkushtim dhe disiplinë të tregojnë edhe në stërvitjet e tjera të kësaj natyre.



WUHAN TË KINËS: "LOJRAT OLIMPIKE USHTARAKE BOTËRORE 2019"

Nëntetarja Luiza Gega në vendin e tretë, merr medaljen e bronzit

Në lojërat e 7-ta Olimpikë Ushtarake Botërore, morën pjesë 12.000 sportistë nga 109 vende të botës



Sportistja e njohur shqiptare, që njëherazi është edhe nëntetare në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, Luiza Gega, ka fituar medaljen e bronzit në lojërat e 7-ta Olimpikë Ushtarake Botërore, që u zhvilluan në Kinë nga data 18 deri 27 tetor 2019. Në këtë finale Luiza vrapoi bashkë me katër finalistë të Botërorit të Atletikës "Doha 2019". Ajo gjithashtu rikonfirmoi normën olimpikë me kohën 9'26" për "Tokyo 2020".

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, në një reagim të saj thekson se Gega na ka nderuar të gjithëve. Sipas Xhaçkës, të tjera paraqitje dinjitoze priten prej saj.

"Flamurtarja e ekipit të FA shqiptare në Lojërat Olimpikë Ushtarake Botërore në Wuhan të Kinës, nëntetare Luiza Gega na nderoi të gjithëve duke fituar medaljen e bronzit në 3000 m me pengesa"-, thekson Xhaçka në reagimin e saj. Luiza Gega fitoi vendin e tretë në garën 3000 metra me pengesa. Vendin e parë në këtë disiplinë e mori, Winfred Yavi, ndërsa vendin e dytë slovenia, Marusa Mismas. Nisur nga fakti që këto lojëra janë event të madh sportiv botëror pas lojërave olimpikë, kjo është një arritje e madhe jo vetëm për Forcat e Armatosura, por edhe për Shqipërinë. Po në të njëjtën garë, 3000m me pengesa për meshkuj, rezultat të mirë gjithashtu shënoi major Bledar Mesi duke u pozicionuar në vendin e 10-të, në baterinë e tij me kohën 10'21".

Ekipi i FARSH përbëhej nga nëntë pjesëmarrës, nga strukturat e Forcave të Armatosura, të cilët gar-

uan në atletikë 1500m dhe 3000m (pengesa) për meshkuj dhe femra, maratonë 42km, mundje e stilit të lirë dhe xhudo. Ky është edicioni i 7-të i Lojërave Olimpikë Ushtarake Botërore, të CISM, dhe Forcat e Armatosura shqiptare marrin për herë të tretë.

Në lojërat e 7-ta Olimpikë Ushtarake Botërore, që u zhvilluan në Wuhan të Kinës morën pjesë rreth 12.000 sportistë dhe zyrtarë, nga 109 vende të botës, të cilët konkuruan në 23 sporte olimpikë dhe ushtarake, gjatë 10 ditëve të zhvillimit të garave.

Për herë të parë në historia e Lojërave Botërore Ushtarake, në Kinë u ngrit një fshat olimpik për sportistët para fillimit të Lojërave. Fshati u hap zyrtarisht për sportistët pas ceremonisë së ngritjes së flamurit më 18 tetor 2019. Kombi pritës Kina kishte një delegacion të përbërë nga 553 pjesëmarrës për lojërat, i cili shënonte numrin rekord

të pjesëmarrësve për të përfaqësuar një komb në Lojërat e vetme Ushtarake Botërore. Në stadiumin me 60.000 spektatorë, Presidenti kinez Xi Jinping hapi më 18 tetor zyrtarisht Lojërat, duke thënë: "Tani unë i shpall të hapura Lojërat Botërore Ushtarake 2019". Lojërat e mëparshme janë zhvilluar në: Romë, Itali 1995;



Zagreb, Kroaci 1999; Catania, Itali 2003; Hyderabad, Indi 2007; Rio de Janeiro, Brazil 2011.



Morën pjesë rreth 2500 atletë nga 42 shtete të botës

Forcat e Armatosura: 200 atletë në maratonën “Tirana Marathon”

Në garën e 21 km për femra fituese u shpall atletja e njohur ushtarake Luiza Gega

Rreth 200 atletë nga Forcat e Armatosura shqiptare u bënë ditën e dielë, më 13 tetor 2019, pjesë e aktivitetit më të madh sportiv të organizuar nga Bashkia e Tiranës “Tirana Marathon”, 8 prej të cilëve garuan në garën e 21 km dhe të tjerët në garën 10 km. Bashkë me ekipin e Forcave të Armatosura shqiptare, në “Tirana Marathon”, morën pjesë edhe 5 ushtarake nga Kosova, dy prej të cilëve garuan në 21 km dhe tre në 10 km. Në këtë aktivitet, në të cilin morën pjesë rreth 2500 vrapues nga 42 shtete të botës si nga Australia, Japonia, Kili, etj. FARSH kishte pjesë të ekipit të saj edhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçakun si i cili mori pjesë në maratonën e Tiranës, në garën e 10 km, për të dytën herë rradhazi. Në aktivitetin “Tirana Marathon”, ekipi i Forcave të Armatosura, ishte ekipi më i madh në përbërje të ekipeve të tjera të

ngritura dhe me cilësi në brendësi, ku spikasin atletet Luiza Gega në 10 km dhe Bledar Mesi në 10 km si dhe Renato Dorzi në 21 km dhe Leonard Kollçaku në 21 km.

Ekipi i Forcave të Armatosura arriti që të merrte medaljen e e ekipit më të mirë në rang ekipesh me një përfaqësim tepër dinjitoz dhe tepër kompakt duke fituar simpatinë dhe duartrokitjet e të gjithë pjesëmarrësve. Medalja ju dorëzua shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku. “Dua të falenderoj gjithë pjesëmarrësit e Maratonës, por në vecanti ekipin e FARSH, të cilët me përkushtimin, disiplinën dhe profesionalizmin e tyre kanë ditur gjithmonë të ngrenë vlerat e FA por edhe ato kombëtare, pasi anëtarë të FA kanë përfaqësuar denjësisht Shqipërinë dhe kanë valitur Flamurin tonë Kombëtar, brenda dhe jashtë vendit, duke na bërë të ndihemi krenar...” Rezultate të tjera individuale mjaft impresionuese nga personeli i FARSH u arritën nga: Nëntetare Luiza Gega, e Policisë Ushtarake, vendi I për femra në 21 km. Kapiten Renato Dorzi, Forca Ajrore, vendi i 7 për meshkuj në 21 km (vendin e I si atlet shqiptar). Major Bledar Mesi, Policia Ushtarake, vendi 8 për meshkuj në 10 km (vendin e I si atlet shqiptar). Ushtar Sadete Popshini, Forca Tokësore, vendi 8 për femra në 10.

Me pjesëmarrjen dinjitoze dhe rezultatet e shkëlqyera në këtë aktivitet me përmasa të mëdha FARSH tregoi edhe një vlerat më të mira si pjesë elitë e shoqërisë. Për herë të parë maratona e ardhshme që do të zhvillohet vitin tjetër në Tiranë, do të ketë disiplinë të saj maratonë të plotë 42 e 195 m, ku FARSH do të dyfishojë numrin e pjesëmarrësve të tyre në maratonë.



Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës së ambienteve të Komandës Mbështetëse dhe iniciativës së marrë nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, në gusht të këtij viti, filloi puna për krijimin e një ambienti sportiv për efektivin e kësaj komande dhe të reparteve të saj vartëse.

Për këtë u ngrit grupi i punës i Komandës Mbështetëse, i kryesuar nga Dega e Operacioneve dhe Stërvitjes, Dega e Logjistikës, si dhe Kompania e Mbështetje, për vënien në funksionim të një fushe futbollli dhe volejbollli, sipas të gjitha parametrave dhe standardeve të kërkuara. U deshën rreth dy muaj që kjo fushë të vihej në përdorim për efektivet e Komandës Mbështetëse dhe në përfundim të punimeve u zhvillua një ceremoni për inaugurimin e saj.

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Sallaku falënderoi në mënyrë të veçantë efektivet e Kompanisë së Mbështetjes për punën e palodhur

Komanda Mbështetëse me ambjent të ri sportiv



U deshën rreth dy muaj që kjo fushë të vihej në përdorim për efektivet e Komandës Mbështetëse dhe në përfundim të punimeve u zhvillua një ceremoni për inaugurimin e saj.

dhe përkushtimin maksimal për përfundimin e punimeve në kohë dhe me cilësi, pa lënë mënjane mbështetjen e dhënë nga Dega e Operacioneve dhe ajo e Logjistikës.

Në përfundim, gjeneral brigade Sallaku la si detyrë që shembullin e Komandës Mbështetëse ta ndjekin dhe repartet vartëse të saj për krijimin e ambienteve sportive.

Komanda Mbështetëse ka përzgjedhur ekipin e saj, i cili do të marrë pjesë në kampionatin sportiv të qitjeve në rang Forcash të Armatosura. Për zgjedhjen e tyre, nën drejtimin e Specialistit të Stërvitjes, Kapiten Enkeled Manoku, u zhvilluan qitjet përgatitore me 14 efektive ushtarake "oficer, nenoficerë dhe ushtar me armët e këmsorisë AK 47 mod 56 dhe pistoletë TT mod 54. Nga pikët e marra rezultojnë shtatë ushtarake oficerë, nënoficerë e ushtarë me rezultate të shkëlqyera, të cilët janë: N/Kolonel Lavdim Çota, Major Gerti Gjokmena, Kapiten Fabiola Lipe, Toger Endri Deda, N/Toger Ledio Halili, N/Toger Anisa Haxhiaj, UPIV Amelda Popshini, të cilët do të përfaqësojnë ekipin e KM.

Qitësit më të mirë të KM për vitin 2019





QENDRA KULTURËS, MEDIAS, BOTIMEVE
TË MBROJTJES, DHE MUZEUT TË FA

Kursi i Pikturës një ditë në kështjellën e Rozafës në Shkodër



Në Qendrën e Kulturës me dhjetra fëmijë të ushtarakë të FA janë pjesë e kurseve të pikturës, muzikës, aktrimit dhe sporteve

Një nga prioritetet e Qendrës Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, dhe Muzeut të Forcave të Armatosura është edhe ngritja e grupeve apo Kurseve me fëmijë të ushtarakëve ku ata mundet të ushtrojnë talentin e tyre në fusha të tilla si piktura, muzika, kënga, futbollit, volejbollit apo edhe basketbollit. Me fëmijet sipas profileve dhe talenteve punojnë artistë dhe figura sporti të mirënjohur si: Kozma Dushi, Redon Makashi, Gazment Çaçi, Arben Sako, Ilir Lame, etj. Nuk janë të pakta aktivitetet që zhvillojnë këta fëmijë duke dhënë koncerte e duke hapur ekspozita pikturash apo ndeshje sportive përpara prindërve ushtarakë, duke shkuar edhe në reparte ushtarakë jashtë kryeqytetit, por edhe duke bashkëpunuar me moshatarë të shkollave të kryeqytetit apo rrethëve.

Të shtunën që kaloi fëmijët e Kursit të Pikturës zhvilluan një aktivitet në kalanë Rozafa të Shkodrës. Aty fëmijët skicuan në ambjentet e bedenat e kalasë pikturat e tyre, të cilat do ti plotësojnë apo mbushin kur të kthehen në Tiranë, çdo javë pranë qendrës. Për aktivitetin e piktorëve të vegjël kujdesej dhe u rrinte mbi kokë instruktori i pikturës, piktori Zhani Tase. Fëmijët në këtë aktivitet shoqëroheshin edhe nga specialistët nga Sektori i Aktiviteteve si Kozma Dushi, Olger Davilli dhe Denis Biraku.

Vetë ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka e përshëndeti këtë veprimtari të piktorëve të vegjël. "Forcat e Armatosura janë një familje e madhe që nuk e bashkojnë vetëm armët. Këta janë fëmijët e ushtarakëve të Kursit të Pikturës, të cilët fundjavën që kaloi vizituan kështjellën e Rozafës në Shkodër. Në Qendrën tonë të Kulturës me dhjetra fëmijë të efektivëve të FA janë pjesë e kurseve të pikturës, muzikës, aktrimit dhe sporteve", shkruan ministrja Xhaçka ne facebook. Por gjatë vizitës në kështjellën e Rozafës në Shkodër, fëmijët u njohën edhe me muzeun e kalasë, ku Ndriçim Mlika, përgjegjës i Muzeut në Kështjellën e Rozafës në Shkodër, u foli fëmijëve për historikun mijëra vjeçar të kalasë dhe interesimin që është shtuar vitet e fundit për ta vizituar atë.






Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më datë 17 tetor 2019, në kuadër të vizitës së tij zyrtare në SHBA, vizitoi Universitetin e Norwich-it në Vermont.

Gjeneral Rama në emër të Ministrisë së Mbrojtjes ka nënshkruar Marrëveshje mirëkuptimi me Universitetin e Norwich-it për të bashkëpunuar në fushën e edukimit, hulumtimit shkencor në fushën ushtarake, si dhe garave në mes të kadetëve të këtyre institucioneve.

Pas nënshkrimit të këtij memorandumi, Gjeneral Rama e falënderoi presidentin e këtij institucioni Richard Schneider për besimin dhe mundësinë e dhënë duke theksuar se ky bashkëpunim do të kontribuojë në avancimin e njohurive dhe përvojave të kadetëve të të dyja institucioneve. Gjeneral Rama së bashku me delegacionin e tij të përbërë nga kolonel Ilir Qeriqi, atashe i Mbrojtjes në SHBA, major Korab Dauti SHPFSK dhe major Jaser Mulla, asistent ushtarak i KOMFSK-së, patën rastin të vizitojnë Qendrën Trajnuese për Mbrojtje Kibernetike, ku nga stafi i kësaj qendre janë njoftuar për funksionimin dhe mbarëvajtjen e procesit të saj mësimor.

Me një traditë 200-vjeçare, Universiteti i Norwich-it, i cili njihet edhe si Kolegji Ushtarak i Vermontit, konsiderohet të jetë institucioni ushtarak më i vjetër në SHBA. Me një staf mjaft profesional dhe me një eksperiencë të jashtëzakonshme, qëllimi i këtij kolegji është që të edukojë dhe



BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET USHTARAKE AMERIKANE

FSK: Marrëveshje mirëkuptimi me Universitetin e Norwich-it

Me një traditë 200-vjeçare, Universiteti i Norwich-it, i cili njihet edhe si Kolegji Ushtarak i Vermontit, konsiderohet të jetë institucioni ushtarak më i vjetër në SHBA

të trajnojnë kadetët e rinj për të qenë liderë të ushtrisë amerikane. Realizimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi pritet të fillojë në vitin 2020. Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ishte në Amerikë, me ftesë zyrtare të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga data 14-16 tetor 2019, ku mori pjesë në njërin prej aktiviteteve më të mëdha ushtarake që organizohen nga kjo shoqatë. Në këtë aktivitet kanë marr pjesë më se 90 shtete të botës, ku përveç konferencave të ndryshme që ndërlihen me aspektet e sigurisë u mbajt edhe panairi i industrisë ushtarake amerikane, i cili konsiderohet si njëri ndër panairët më të mëdha në botë. Gjeneral Rama në këtë panair vizitoi edhe disa kompani amerikane me pajisje dhe sisteme ushtarake. Gjithashtu, në kuadër të këtij aktiviteti, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, mori pjesë edhe në koktejin e organizuar nga shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane, gjenerali James McConville. Me këtë rast,

gjeneral Rama e ka falënderuar gjeneralin McConville si dhe ushtrinë amerikane për mbështetjen e vazhdueshme në zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të FSK-së. Komandanti i FSK-së po ashtu ka zhvilluar takime të rëndësishme edhe me përfaqësues të Departamentit të Mbrojtjes, para të cilëve pasqyroi të arriturat e FSK-së, si dhe shprehu dëshirën e tij për rritjen e bashkëpunimit dhe të mbështetjes nga Departamenti i Mbrojtjes. Në këto takime gjenerallejtënant Rrahman Rama i ka siguruar përfaqësuesit amerikanë të Mbrojtjes se plani i tranzicionit është duke u zhvilluar sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit me transparencë të plotë. Ky aktivitet i Shoqatës së Ushtrisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka për qëllim mbështetjen e ushtrisë amerikane, duke i bashkuar të gjithë përfaqësuesit e lartë të ushtrive të botës për të debatuar rreth çështjeve të ndryshme të kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë në botë.

FSK në Britaninë e Madhe, në stërvitjen “Cambrian Patrol 19”

Stërvitja “Cambrian Patrol” ka filluar që nga viti 1959, dhe në mbarë botën njihet si një nga patrullat më të vështira

Një kontingjent i Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK) ka udhëtuar drejt Britanisë së Madhe, për të marrë pjesë në garën ushtarake ndërkombëtare „Cambrian Patrol 19“, e cila po zhvillohet nga data 6 deri më 21 tetor 2019. Forca e Sigurisë e Kosovës, me qëllim të zbatimit të misionit të saj dhe me synim që të arrijë rezultate në përputhje me standardet e kërkuara bashkëkohore, në këtë ushtrim po merr pjesë në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Britaninë e Madhe. Stërvitja „Cambrian Patrol 19“ është aktiviteti më prestigjioz ushtarak, që realizohet nga Brigada 160 e këmbësorisë, dhe është ushtrim kryesor patrullues për ushtrinë e Britanisë, i cili është i hapur për të gjitha shërbimet ushtarake të Britanisë dhe shërbimet e tjera ushtarake ndërkombëtare.

Këtë vit, kontingjenti i FSK-së, që nga muaji shkurt ka bërë përgatitje intensive si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri në disiplina të ndryshme; duke filluar nga Faza përgatitore për këtë ushtrim, e cila ka zgjatur rreth 8 muaj të plotë, ku janë përfshirë 3 muaj parapërgatitje dhe 5 muaj trajnim intensiv. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës po marrin pjesë në këtë garë për herë të tretë dhe se FSK-ja për herë të parë mori pjesë në këtë garë në vitin 2016, dhe në mesin e shumë shteteve pjesëmarrëse kontingjenti i saj pati marrë „Medaljen e artë“, ndërsa në garën e vitit 2018 kontingjenti i FSK-së ishte shpërblyer me “Medaljen e bronzit”. Stërvitja “Cambrian Patrol” ka filluar që nga viti 1959, dhe në mbarë botën njihet si një nga patrullat më të vështira, ku një numër i vogël skuadrash arrijnë të dekorohen me medalje, ndërsa shkalla e dështimit është mjaft e lartë.



QENDRA PËR STUDIME UNIVERSITARE E AKADEMISË SË MBROJTJES

Datë me rëndësi për FSK-në, 14 rekrutë bëjnë betimin

Në repartet e kazermës „Adem Jashari” të Shtabit të Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë, u zhvillua ceremonia e betimit e rekrutëve të rinj, gjenerata 2023, të cilët filluan vitin akademik 2019/20 në Qendrën për Studime Universitare të Akademisë së Mbrojtjes. Në ceremoni ishin të pranishëm: ministri i Mbrojtjes z. Rustem Berisha, zëvendësministri Kadri Kastrati, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm z. Faruk Geci, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Irfete Spahiu, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, gjeneral Michael Obernayer, gjeneralë, oficerë të FSK-së dhe NALT-it, si dhe shumë familjarë e miq të rekrutëve të rinj. Pas rreshtimit, inspektimit dhe intonimit të himnit shtetëror, fjalën e rastit e paraqiti ministri i Mbrojtjes z. Rustem Berisha, i cili këtë gjeneratë të rekrutëve e cilësoi si gjeneratën më me fat: “Kjo është një datë me rëndësi për FSK-në. Ju jeni gjenerata e parë e kadetëve që keni nderin t’i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Sot, duhet të jeni krenarë për arritjet tuaja dhe të zotoheni që gjithmonë do ta nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni atdheun, t’i respektoni eprorët tuaj dhe ta mbronni paqen, lirinë dhe shtetin tone. Si Ministër i Mbrojtjes, jam krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara nëpër akademi të ndryshme të vendeve të NATO-s, kanë treguar performansë të shkëlqyer dhe kanë përfaqësuar me nder FSK-në. Pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre”. Në fund të ceremonisë, 14 rekrutët e rinj, para komandantit të QSU-së major Vegim Krelani dhe të pranishmëve të tjerë, solemnisht dhanë betimin si kadetë të FSK-së dhe nënshkruan kontratat për shërbim në FSK.

Vendi ynë gjithmonë e ka parë procesin e zgjerimit si një proces i bazuar në rezultate dhe arritje. Kemi dhënë rezultate për sa i përket stabilitetit politik, lirisë së mediave, por edhe arritjes së disa prej qëllimeve strategjike të qytetarëve, siç është anëtarësimi në NATO që e presim deri në fund të këtij viti”, tha ministrja Radmilla Shekerinska në konferencën me temë “Perspektivat dhe Sfidat e Evropës Juglindore”, që u mbajt në Cavtat, Kroaci, e organizuar nga fondacioni “Friedrich Ebert”.

Ministrja Shekerinska, e cila morri pjesë në panelin e parë për integrimin evropian, sfidat dhe mundësitë për Evropën Juglindore, tha se nëse nuk merret një vendim pozitiv javën e ardhshme për Maqedoninë e Veriut, forcat progresive të gatshme për kompromise të guximshme, për pajtim, për një imazh tjetër, demokratik dhe progresiv të Ballkanit do të ndiejnë mungesë interesi nga Bashkimi Evropian. Ajo shtoi se për të promovuar lidhshipin, duhet të ketë vlera, por edhe qëndrueshmëri dhe besueshmëri. Në konferencë marrin pjesë shumë anëtarë të Parlamentit Evropian, parlamentarë nga Gjermania, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, përfaqësues të komunitetit akademik dhe sektorit të OJQ-ve.

Shekerinska: Zgjerimi i Aleancës, proces i bazuar në rezultate



Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Mbrojtjes Kombëtare e Republikës së Greqisë nënshkruan më 30 shtator 2019, në Selanik një Marrëveshje Teknike për Mbikëqyrjen e Hapësirës Ajrore. Marrëveshja, e cila u nënshkrua nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Vasko Gjurçinovski dhe Shefi i Mbrojtjes, gjenerali Hristos Hristodulu, është një zyrtarizim i misionit “Air-policing”, i cili do të zbatohet në koordinim me NATO-n. Marrëveshja e nënshkruar buron nga Marrëveshja e re e Bashkëpunimit të Mbrojtjes, e nënshkruar nga ministrat e

Greqia do mbikqyrë hapësirën ajrore të Maqedonisë së Veriut

Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe Evangelos Apostolakis, gjatë një vizite në prill nga një delegacion i lartë qeveritar i Greqisë në vendin tonë. Përndryshe, në muajin maj me dy fluturime në hapësirën ajrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga avionët F-16 të ushtrisë greke, është kryer fluturimi i parë provë për misionin e NATO-s “Air policing”, në mënyrë që të kontrollohet komunikimi dhe mbulimi me radar në hapësirën tonë ajrore.

Misioni “Air-policing” është një përfitim ekskluziv që vlen vetëm për

vendet anëtare të Aleancës dhe përfshin përdorimin e sistemit për monitorim të hapësirës ajrore dhe menaxhimin me sistemin e kontrollit të komandave të forcave ajrore me forcat dhe mjetet përkatëse të mbrojtjes kundërajrore, përfshirë avionët luftarak. Qëllimi është mbrojtja e integritetit të hapësirës ajrore të vendeve anëtare të NATO-s. Edhe anëtarë i fundit i NATO-s, Mali i Zi, gjatë anëtarësimit në NATO, nënshkruan marrëveshje teknike për „Air-policing” me Greqinë dhe Italinë.

Gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski dhe gjeneral Christos Christodoulou

Gjenerallejtënant Gjurchinovski zhvillon vizitë zyrtare në Greqi

Shefat e Shtabit të Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut: gjeneral Christodoulou dhe gjenerallejtënant Gjurchinovski kanë nënshkruar në selanik marrëveshjen teknike për policinë ajrore

Shefi i Shtabit të Ushtrisë Gjenerallejtënant Vasko Gjurchinovski zhvilloi më 30 shtator 2019, vizitën e tij të parë zyrtare në Forcat e Armatosura Greke në selinë e Korpusit të NATO-s për vendosjen e shpejtë në Selanik.

Pas marrjes së nderimeve të larta ushtarake në Korpusin e NATO-s, gjeneral Gjurchinovski u takua me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Mbrojtjes Greke, gjeneralin Christos Christodoulou, si dhe me Komandantin e Korpusëve të NATO-s Gjeneral Lejtënant Kostandinos Kutrasinos të kësaj komande.

Në takim midis gjeneralëve Gjurchinovski dhe Hristodolu u diskutua bashkëpunimi dypalësh ushtarak, i cili është i rëndësishëm jo vetëm për marrëdhëniet si aleatët e fundit të NATO-s, por edhe për sigurinë e të gjithë rajonit.



Ata diskutuan gjithashtu për avancimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dypalësh ushtarak si aleatët e ardhshëm të NATO-s mbi bazën e

një marrëveshje bashkëpunimi mbrojtjeje të nënshkruar nga ministritë e mbrojtjes të të dy vendeve. Në kontekstin e vendimeve të traktatit, Shefat e Shtabit kanë nënshkruar marrëveshjen teknike për policinë ajrore. Takimi u përqëndrua gjithashtu në aktivitetet e vazhdueshme dhe të ardhshme të kryera nga Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore në procesin e integritit të plotë në strukturat e NATO-s.

Delegacioni i kryesuar nga gjeneral Gjurchinovski vizitoi edhe Brigadën e 34-të të Mekanizuar të Forcave të Armatosura Greke, ku pas takimit me Komandantin e Brigadës, ai u njoh me aktivitetet, misionin dhe detyrat e Brigadës. Bashkëpunimi ushtarak midis dy ushtrive deri më tani është mbuluar kryesisht nga nisma SEDM, Brigada e Evropës Juglindore, por edhe në fushën e trainimit ushtarak të anëtarëve në institucionet e arsimit të lartë grek dhe studimin e gjuhës greke.



Lufta për vilajetin e Janinës në katër epoka

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Historia e luftimeve është romani më i përgjakshëm i njerëzimit, një romani pambarim për popujt që ka të shkruar në "faqet" e betejave fitues dhe humbës, triumfues dhe të mundur. Në faqet e betejave nga hulumtimi në analet historike gjejmë beteja të pafund të shqiptarëve në Jug e veri në lindje e perëndim të vendit, sikurse gjejmë nëpër shekuj luftime të treve sa të mençur aq edhe luftarake, Labërisë. Sundimi osman në Shqipëri filloi pas Betejës së Savrës më 18 shtator 1385, pranë Lushnjës, kur shumica e prijësve vendas ranë nën vasalitetin e osmanëve. Osmanët ngritën garnizonet e tyre në Shqipërinë jugore deri në vitin 1415 dhe themeluan një juridiksion zyrtar mbi shumicën e Shqipërisë deri në vitin 1431, vit që njihet edhe si zotëruar të Janinës nga ana e osmanëve. Betejat e bijëve të Labërisë kanë qenë mbrojtëse të truallit e jetës afër e larg vendbanimeve të tyre. Si pjesëtarë luftarakë vitalë të Vilajetit të Janinës lebërit katër herë kanë qenë në "portat" e Janinës si gardianë të lirisë së trojeve. Janina ishte qyteti më i madh jugor shqiptar përpara vitit 1913. Janina ka qenë çelësi historik i së ardhmes sepse atje shkruhej historia me luftë e ushtri, me politikë, diplomaci, intriga, por dhe me tradhëti. Katër herë në gjashtë dekada ushtritë u përballën bajonetë me bajonetë më 1854, 1878, 1897 dhe në vitet 1912-1913. Gjaku i derdhur nuk ka çmim sepse trualli dhe gjaku i të parëve është i paçmueshëm. Por sot kohët kanë ndryshuar dhe përparësia shqiptare është euroatantizmi dhe bashkësia e përbashkët europiane.

Lufta e parë për Vilajetin e Janinës (1852-1854)

Situata politiko-ushtarake në Ballkan, në vitet 1852-1854, ishte e ashpërsuar. Perandoria osmane ishte drejt dobësimit e degradimit. Në anën tjetër Rusia përpigë që të shfrytëzonte këtë situatë duke nxitur ortodoksinë për turbullira me qëllim që të fitonte terren e të realizonte synimet e objektivat e saj për shtrirje tokësore. Anglia kishte gjithashtu interesat e veta aty dhe ishte shprehur jo pajtuese me nismën zgjeruese dhe kishte lëvizur edhe mjete e trupa detare, që të mos cënoheshin pozitat e

saj në ishujt jonianë dhe të mos lejonte përhapjen e influencës ruse në Ballkan, sepse dëshironin të ruanin statuskuonë. Franca qëndronte në pozita neutrale. Vërshimi i bandave greke në tokat jugore shqiptare që ishin nën pushtimin osman, alarmuan shqiptarët edhe përtej krahinave të prekura drejtpërsëdrejti. Para këtij sulmi të rrezikshëm, për mënjanimin e copëtimit të Shqipërisë, bijtë e këtyre krahinave morën përsipër mbrojtjen e integritetit tokësor jugor shqiptar. Ndërkohë që marrëdhëniet "e vështira" në mes dy shteteve, të përsëritura në forma të ndryshme, të shoqëruara me kriza kanë synim "kontrollin në pikëpamje strategjike të kufijve tokësor e detar". Shqiptarët që shkuan në fushën e betejës, ndër të parët ishin Mahmud bej Vlora komandant i dy taboreve labe, Selim pashë Vlora, Halit bej Frashëri; Xhelil Bega 53 vjeçar (që më vonë preferoi të quhej Çelo Picari); Bajo Kazo e Habil Xhuvani që janë edhe dy dëshmorët e parë nga Fushëbardha; Kalem Hadëri nga Picari, Hasan Çako nga Kaparjel, Ibrahim Sino gjirokastriti, Ahmet Çapari nga Luarat i Margëlliçit, Selam Hasani nga Velça, Shako Xhaka nga fshati Tërbaç, etj. Është me vlerë për njohjen nga treva labe e më gjerë momenti i shpërthimit të kryengritjeve në Artë



THE SURRENDER OF YANINA, 1913.

One of the most important events in the war between the Balkan States and the Turks was the capture of Yanina, the fifth strongest fortified town in the world, which fell to the Crown Prince of Greece on March 6th, 1913. The inhabitants, who are Greeks, after five hundred years of Turkish dominion, gave their city rulers an enthusiastic welcome. The town was formally surrendered to General Soutas by Vehid Bey, the brother of Essad Pasha.

dhe në rajonet malore të Epirit, edhe pse disa qytete shqiptare ranë në duart e grekëve si Paramithi, Suli, Çamanta. Situata ndërlikohej. Forca të shumta shqiptare u ngritën nga gjithë jugu shqiptar. Më 12 mars 1854 shqiptarët sprapsën bandat greke në trevën e Vlorës dhe vendosën qetësinë dhe rendin. Rreth 500 lebër u drejtuan drejt tokave të Vilajetit të Janinës, në trevën e Thesprotisë/Çamërisë, për të përzënë bandat që terrorizonin popullsinë. Nga mosha 15 deri në 75 vjeç rrokën armët. Të dhënat flasin se kjo forcë u rrit shumë dhe nga pesëqind luftëtarë më vonë u bënë edhe një mijë, tre mijë dhe arriti në mbi dhjetëmijë luftëtarë, sa edhe kënga thoshte: "Mahmud bej me dhjetë mijë/ Veqil kish sheh Alinë/ Tutje uxhum për Athinë", u nisën në mbrojtje të tokave shqiptare të Vilajetit të Janinës, në Janinë, Mecovës, Artë, etj. Luftëtarët e Lumit të Vlorës, të udhëhequr nga Selam Hasani nga Velça e Shako Xhaka nga Tërbaçi, u hodhën fillimisht në krahinë e Himarës. Atje, të bashkuar me forcat beratase dhe me trimat e bregdetit të udhëhequr nga kapedan Sokrat Leka prej Qeparoi dhe Mëhill Qirjaqi nga Çorraj, hodhën në det bandat greke. Çelo Picari, i pajisur edhe me disa topa, u fut në thellësi dhe çlirroi Prevezën. Duke i bërë analizën historike gjendjes fronti i mësymjes ishte i gjerë me shumë drejtime, por i copëzuar, e jo frontal që kërkonte kundërvënie totale, në nivel operativo-strategjik. Forcat luftarake shqiptare u bënë të konsiderueshme, edhe më shumë se bandat greke. Në këtë luftë më 1854 u përfshi e gjithë Shqipëria e jugut. Ndërsa ushtria greke luftonte me banda të nxitura, që kërkonin të zgjeronin gjeografinë e tyre. Shqiptarët ishin ngritur të gjithë në këmbë me një qëllim final që të mbronin kufirin në jug të vendit. Kur grekët mendonin se fituan aty në jug të Vilajetit mbritën forcat e Labërisë me Mahmud bej Vlorën (babain e Ismail Qemalit) dhe i sprapsën ata. Prandaj është përjetësuar në këngë: "Mahmud bej me pesë mijë/ Duall mileti i prinë/ Nuk e mbanin dot gëzimë/ Murzikat filluan të bijnë..". Historia ka rregjistruar Mahmud Bej Vlorën (Vlorë 1809-Stamboll, 1866) si pinjoll i oxhakut të Vlorajve, ndër krerët e kryengritjes antitanzimat në vitet 1843-1847. Ai ishte i biri i Ismail beut dhe Nasipe hanëm Vlorës. Pas vrasjes së babait të tij Ismailit me të vëllanë Muhamedin, u internua në Berat dhe më pas në Gjirokastër në vitet 1829-1831. Falet dhe i rikthehet një pjesë e pasurisë. Më 1848 familja u internua: burrat në Konia dhe gratë me fëmijët në Selanik. Pasi u lirua, më 1854 mblodhi vullnetarë për të shtypur kryengritjen e Epirit, në ngjarjet e Grivasit; ku për të përballuar shpenzimet (ylefet) e vullnetarëve u detyrua të shesë çifligjet e fundit që i kishin mbetur në Goricë, Babicë, Novoselë, Selenicë, Subënj e Picar. Shkoi në Stamboll për të siguruar rimbursimin për harxhimet për kryengritjen, por nuk u mbështet. Pas një qëndrimi dyvjeçar në Athinë nën mbrojtjen e monarkut, u kthye sërish në Stamboll ku vdiq më 1866. Luftëtarë të tjerë labër që shkëlqyen në fushëbetejë ishin edhe Kalem Hadëri (Seferi), nipi i Çelos, me një pjesë të mirë të luftëtarëve të Fushëbardhës, Zhulatit, Kolonjës, Golëmit, Kardhiqit shkuan në Delvinë dhe pasi pastroi vendin nga bandat, u hodh në Filat e më tej sipas drejtimeve luftarake. Në trojet shqiptare u lëshua kushtrimi më 12 mars 1954, dhe asnjë krahinë e jugut të saj nuk mbeti pa nxjerrë luftëtarë. Forca të tilla u ngritën në këmbë në Labëri,

por edhe në Danglli, Dishnicë, Shqeri, të udhëhequra nga Halil bej Frashëri, i cili mori me vete edhe djalin e tij për ta stërvitur në luftë si një patriot të ardhshëm 16 vjeçar, Abdyl Frashërin. Fillimisht luftëtarët shqiptarë u bënë thirrje forcave greke që të tërhiqeshin nga teritori shqiptar, duke iu drejtuar komandantëve, mes të cilëve ishte edhe ndonjë renegat shqiptar, ish-oficerë të lartë të Ali Pashës e pastaj të shitur për napolona, si Griva dhe Karaiskaqi. Fakt është se pasi gjetën hezitim në bisedime, në këto rrethana, fjala u mbeti gjuhës së armëve. Shqiptarët korrën fitore në atë front, duke thyer kundërshtarët. Bandat u detyruan të tërhiqen. Luftë u zhvillua kudo në teritorin e Vilajetit. Shqiptarët, që luftonin në këmbë, i detyruan forcat greke të braktisnin pozicionet strategjike të Sulit, siç ishin forcat e Kolonel Zervës. Suksesi nuk i linte luftëtarët shqiptarë të tërhiqeshin. Forcat shqiptare dëshironin që të vijonin përparimin më tej, prandaj kënga labe oshëtinë kohrave: "Burra të bëjmë beeline,/ta bëjmë Bajramë në Athinë..", sepse në fakt ishte muaji maj 1854 dhe që atë muaj kishte qëlluar të ishte dhe festa e Bajramit. Në Mecovë shkoi edhe kapedan Selam Hasani, me forcat e veta nga Lumi i Vlorës, ku luftoi dhe u vra. Kënga popullore e kanë bashkëshoqëruar historinë, kanë sjellë kronikat e gjalla luftarake të historisë, aq sa folkloristi Fatos Meronrapaj, thotë: "...i besoj më shumë një këngë të kënduar, se sa një historie të shkruar". Nga këngët rrjedhin ngjarjet e personazhet historikë pjesmarrës në luftë, bëmat e tyre, heroizmi, rënia në fushëbetejë, moti e terreni që shoqëronte betejat etj. Luftat e vitit 1854 u përjetësuan në këngët e popullit: "...U dogjën toskët e shkretë,/U dogjën edhe u vranë./Për të ruajtur vatanë". Kanë kaluar dekada nga kjo luftë e rrethanat historike dhe kanë ndryshuar. Sidoqoftë, historia ngelet aty, ajo duhet kujtuar, nuk harrohet, sepse lufta për integritetin tokësor, sakrificat dhe gjaku shqiptar është i paharruar edhe pse i derdhur përpara më shumë se njëqind e pesëdhjetë vitesh. Këngët këndohen edhe sot dhe mbeten lejtmotiv për bashkëjetesë paqësore mes fqinjësh. Luftën e Mahmut bej Vlorës me luftëtarë të Labërisë përfshi Lumin e Vlorës përcillen brez pas brezi dhe mbahet mend e tregohet edhe sakrificat që bëri Mahmut bej Vlora para dhe pas përfundimit të luftës që "shiti në Vlorë e në Berat shtatë çifligje, sipas Eqrem bej Vlora në kujtimet e veta, për të shpërblyer çetarët që morën pjesë në luftë e që ngeli edhe fukara, duke ua përcjellë atë bijve të vet". Pinjollët e Vlorajve e kanë drejtuar Vlorën për më shumë se 350 vjet, ndërkohë që të rënë në betejat e 1854 përlllogariten në rreth 3000 luftëtarë, nga të cilët më shumë se 1500 e tyre ishin shqiptarë.

Lufta e dytë për Vilajetin e Janinës (1878)

Osmanët i kishin "shkrirë" bateritë e makinerisë ushtarake në shekujt e parë të pushtimit, prandaj lufta Ruso-Osmane e viteve 1877-1878 i dha goditje të rëndë instalimeve ushtarake osmane në Ballkan. Perandoria Osmane në mbante në zotërim vetëm vilajetet shqiptare dhe Ballkanin Lindor. Nga fundi i 1877 qëndresa u bë edhe më e vështirë dhe situata më komplekse. Më 13 dhjetor 1877 Serbia dhe Mali i Zi i shpallën luftë Perandorisë Osmane duke u mbështetur tek Ushtria Ruse



dhe i shtrinë sulmet e tyre në Shqipërinë Veriperëndimore dhe Verilindore. Pas pushtimit të këtyre territoreve, administrata osmane, shumica e së cilës ishte e etnisë shqiptare, lironin territoret dhe dëboheshin. Në këtë luftë, ushtria serbe shpërnguli ose dëboi shumicën e popullsisë muslimane nga sanxhaku i Nishit drejt Vila- jetit të Kosovës. Ndërkohë që më 27 shkurt 1878 andartë grekë, të udhëhequr nga qarqe të ortodoksisë zbarkuan në Sarandë dhe pas luftimesh të përgjakshme shtinë në dorë Qafë Gjashtë dhe Kalanë e Lëkurësit. Por më 4 mars 1878, ata u dëbuan dhe u shpërndanë nga njësitë ushtarake të Janinës dhe cetat e luftëtarëve popullore të Labërisë. Shqiptarët druanin se mos territoret e tyre do të ndaheshin mes Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë i mbushi me zell për të bërë qëndresë luftarake për të ruajtur tërësinë territoriale. Një ndër ngjarjeve që ishte në sinkron me luftën ruso-osmane të viteve 1877-1878, ishte kryengritja e Epirit e 1878, e mbështetur nga oficerët grekë, edhe pse qeveria greke duke parë gjendjen ndërkombëtare nuk e mbështeti hapur. Kryengritja nisi dhe përfundoi me përfundimin e luftës ruso-osmane. Rusia i shpalli luftë Perandorisë Osmane më 24.4.1877 dhe pas disa betejash humbja osmane dukës qartë, prandaj edhe disa qarqe jozyrtare greke e vlerësuan si mundësi të artë për të nxitur trazira ndaj pushtetit e administratës Osman dhe që Greqia kishte pretendime territoriale si Epiri, Thesalia e Kreta. Greqia "nuk veproi vetë", por nëpërmjet dy organizatave kryengritëse në Epir: "Mbrotjta Kombëtare" dhe "Vëllazëria", të cilat grumbulluan armë, ndihma dhe vullnetarë. Në dhjetor 1877, kanë qenë gati të udhëhiqnin kryengritjen dy gjeneralë të ushtrisë greke: Mihal Spiromilo dhe Dhimitër Boçari (i biri i Noti Boçarit që kish marrë pjesë në luftimet e vitit 1854), por qeveria greke duke ju trembur gjendjes ndërkombëtare ndërhyri e ndaloi përzjerjen e oficerave të saj në këto banda. Në shkurt 1878 banda "vullnetarësh" kaluan kufirin dhe hynë në Thesali e Epir, por pas përpjekjeve të para një pjesë e konsiderueshme e banditëve u tërhoqën nëpërsëri. Një postë osmane në Plakë u mor nga bandat, por me arritjen e forcave të konsiderueshme osmane u detyruan të tërhiqeshin. Lufta ruso-osmane që kishte filluar më 24.4.1877 përfundoi me traktatin e Shën Stefanit (në Jeshilkoj të Stambol- lit), më 3.3.1878, kjo gjë pati ndikim negativ mbi lëvizjen.

Më 12.3.1878 përfaqësuesit e lëvizjes greke shpallën bashkimin e Epirit me Greqinë, por menjëherë arriti një trupë ekspedite osmane e cila vuri nën kontroll gjithë Epirin dhe bandat u detyruan të tërhiqeshin mbrapsht në Greqi. Kryengritjes së epirit i parapriu që në shkurt 1878 sulmi për marrjen e Kalasë së Lëkurësit, pikën dominuese të ndërtuar që më 1537 në kohën e Sulltan Sulejmanit, që sulmoi Korfuzin dhe kontrollonte skelën e Sarandës, por edhe rrugën Sarandë-Butrint. Më 27 shkurt 1878, një bandë greke prej 150 vetash zbarkoi në Sarandë, por kësaj bande ju bashkangjiten dhe 700 vullnetarë të tjerë nga Korfuzi, që komandoheshin nga kolonelët Llapa e Stefani. Ngjarja vjen në këngë: "Të xhumanë që me natë,/në Korfuz, një konsullatë,/shkruan e dërgon një kartë:/Kush është djalë, më këmbë,/të hidhet të zërë vëndë,/se del greku në Sarëndë!. Vargjet janë një dokument arkivor i pakundërshtueshëm: "Shkurti më njëzet e shtatë, u ndez lufta me andartë, në Lëkurës e në Gjashtë". Shqiptarët rrokën armët dhe i pritën me armë bandat greke dhe andartët e vullnetarët. Megjithatë grekët vunë nën kontroll qytetin e Sarandës, Vurgun, Qafën e Gjashtës, Lëkursin e Manastirin e shën Gjergjit. Në këto kushte luftëtarët e të gjitha krahinave dhe komandantët e çetave u organizuan dhe marshuan drejt Sarandës për të organizuar mbrojtjen e Lëkurësit nga pushtuesit grekë. Bashkë me e krijimin e çetave, lindën dhe këngët patriotike të cilat bënë thirrje për organizim e qëndresë ndaj bandave greke: "Dolli greku në Sarëndë,/Kush është djalë në këmbë,/Të hidhet, të zërë vëndë,/Ç'kërkon Jorgua i Greqisë,/Në sinor të Shqipërisë,/Shqipe e zezë si korbi pisë,/Do ta bëjë që të noise". Dhe kënga pasonte: "Ngrehuni lebër me gjak,/na erdhi greku në prag,/U ngritën djemtë me vrap, Djem qenë dyzet e gjashtë, Idriz Alidhima bajrak,/sorqeth pa zorrë në bark". Luftëtarët e krahinave jugore zbritën në fushën e luftës për të "mirëpritur" komshiun e paftuar, sipas zakonit të trashëguar nga të parët. Qëllimi kryesor dhe i vetëm ishte zbrapsja e pushtuesit dhe mos lejimi i pushtimit të Sarandës dhe veçanërisht mbajtja e Kalasë së Lëkursit. Luftëtarët e këtyre çetave udhëhiqeshin nga komandantët trima si: Idriz Alidhima, Rakip Gjocaj nga Zhulati, Bako Çarçani nga Fushbardha, Islam Gjonika nga Fterra, Rakip Delvina, Iliaz Tatëzati, Myslim Zenel Gjoleka, Daut Dermishi nga Lazarati etj. Ngjarja vjen më e pastër përmes këngës: "Kush lufton

përposh në Gjashtë?-/Idriz Palla vet' i shtatë./Mbë udh' poqën lazëratë./Briti Idriz Alidhima:/Përpjet' o burra, o trima,/atje ku lufton martina". Në këto këngë ngrihet lart heroizmi i bijve të Labërisë, njëkohësisht shprehet dhe dhimbja për ata që ranë, 46 vetëm nga fshati Zhulat: "Në xhuma që me natë,/Vjen një ulurimë e thatë./Thanë, u vranë zhulatë./Dyzet e gjashtë mandatë. Në një këngë tjetër thuhet: "Seç erdhi një kartë,/për mbi qir' Vasilë (zotin),/Dolli Jorgj Stefani,/me dyfek martinë./Telit se ç'i ranë,/brenda në Janinë,/Doli në Sarandë,/s'vate dot Delvinë!/Pashait i thanë,/dhe ky mbledh ordhinë./Dha kushtim për Labërinë..". Lufta ishte e përgjakshme, por luftëtarët e Labërisë nuk u tërhoqën. Kënga dëshmon: "Jorgo dhëndërr i Ruisë, /të shoç djemt' e Labërisë,/me jelekë e pa këmishë,/e marrin plumbin në sisë". Kështu me humbje të mëdha e të shpartalluar, bandant greke nuk mund të zinin as anën e detit e të hidheshin nga kishin ardhur në Korfuz, për arsye se gjatë kohës së zhvillimit të përbaljes luftarake një anije ushtarake osmane mbriti nëpër det dhe kishte zënë ngushticën e Korfuzit në ujrat tona dhe nuk ishte e mundur jo vetëm që t'u vinte ndonjë lloj ndihme po dhe askush nuk mund të shpëtonte dot në rast shpartallimi. Dhe kështu ndodhi: "Ç'erdh vapori zeherli,/Nëpër det si mal i zi,/Ruan vendin me dylbi,/Që Sarandë e në Kastri./Ku bie Lëkurësi?/E qëllon në themeli,/Aq sa dil tos dhe hil" Komandanti i garnizonit ushtarak të Janinës u nis kundër tyre i ndihmuar nga forca të shumta vullnetare shqiptare, kryesisht labe. Më 4 Mars 1878 pas luftimeve të ashpra kryengritja mori fund dhe vargu popullor thotë: "Ç'kërkon Jorgua i Greqisë,/Në sinor të Shqipërisë?/I pe djemtë e Shqipërisë?/Të vunë në majë të sfungjisë". Luftëtarët e Labërisë dhe krahinave jugore zbritën në fushën e luftës për të pritur sipas zakonisht shqiptar komshiu e paftuar, për të bërë zbrapsjen e pushtuesit dhe mos lejimin e pushtimit të Sarandës si dhe veçanërisht mbajtja e Kalasë së Lëkurësit. Në Luftën e Lëkurësit më 1878 pati shumë të rënë që jetën e flijuan për truallin shqiptar ndërmjet të cilëve luftëtarët fushëbardhas që derdhën gjakun për atdheun: Idriz Alidhima, Abedin Muho, Seit Dobra, Shahin Mema, Hair Stefani, Sali Isufi, Xhafer Gjoni, Osman Deçka, Shahin Veliu, Mato Asllani etj. Ndërsa në luftën e Palavisë më 1878 ranë Sadik Memushi, Skëndo Xhuvani, Myrteza Sulli, Musa Rafi (Robi) dhe Hito Kongoci. Por të rënë ka pasur nga gjithë fshatrat e Labërisë që i thanë "ndal!" pushtimit të truallit nga bandat. Nga të dhënat del se në këtë luftë, që u vranë edhe rreth 400 anartë banditë, që luftëtarët shqiptarë dhe forcat e ardhura nga Janina e Delvina i lejuan t'i merrnin drejt Korfuzit. Nga ana tjetër që prej luftës së parë të 1854 e në vijimësi nuk ka pasur fshat të Labërisë që nuk e ka njohur dhe nuk ka dëgjuar për trimëritë e labërve në portat e fortesës së Bezhanit. Bezhani në Janinë ishte fortesa kryesore e osmanëve në Janinë, ndërkohë që Janina ndodhet në një lartësi prej 480 m mbi nivelin e detit dhe gjendet në brigjet e Liqenit të Janinës. Distanca nga qytetet e mëdha: 100 km prej Gumenicës, që gjendet në perëndim të Janinës. Fshati Bezhan, në gjuhën greke quhet "Neo Bizani" dhe ndodhet në administrim të Garkut të Janinës, 786 metra mbi nivel të detit. Me emrin e fshatit ose fortesës së Bezhanit, këtij fshati-kodër të lartë e të fortifikuar, lidhet jeta e qindra e qindra labërve që

luftuan dhe ranë në këtë "portë të Vilajetit të Janinës". Toka në Bezhan është mbijtur me gjakun e luftëtarëve, që trupin e kthyen në fortesë mbrojtjeje për truallin amëtar, sepse në fakt mbrohej trualli arbëror dhe jo trualli i pushtuesit osman.

Lufta e tretë për Vilajetin e Janinës dhe vorbulla e lakmive ballkanike (1897)

Shqiptarët dhe çështja shqiptare ka një stacion luftime edhe gjatë Krizës Lindore të vitit 1897. Kështu në mars 1897 shpërtheu lufta greko-osmane për çështjen e Kretës. Gjendja në hapësirën shqiptare u acarua dhe më shumë. Pjesa jugore e Shqipërisë rrezikohej nga forcat greke, por edhe nga ndërhyrja e shteteve të tjera të Ballkanit, Serbisë e Bullgarisë. Trupat greke ishin në kufijtë e Thesalisë të vilajetit të Janinës, ndërkohë që luftonin për Kretën. Në vilajetin e Janinës, udhëheqësit e lëvizjes kombëtare dhe shumica e parisë shqiptare nuk pranuan t'i jepnin Sulltanatit ushtarë se do t'i ruanin forcat për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë. Grekët nuk patën sukses për pushtimin e Kretës në mesin e shkurtit të 1897, Greqia e shtriu luftën në Thesali dhe në vilajetin e Janinës, ku sulmoi forcat osmane më 12 prill 1897. Sulltanati luftën kundër Greqisë e paraqiste si luftë për mbrojtjen e territoreve shqiptare. Atdhetarët shqiptarë, udhëheqës të lëvizjes kombëtare, përbalë rrezikut të pushtimit të Shqipërisë së Jugut nga Greqia, u detyruan të ndryshonin qëndrimin dhe ta përbaltonin me forcat e tyre agresionin grek. Gazeta "Shqipëria" e Bukureshtit shkruante: "Në fillim të luftës greko-osmane, kur grekët luftonin për Kretën, për ta bashkuar ose për autonominë e saj, shqiptarët, të krishterë e myslimanë, simpatizuan luftën e grekëve dhe deklaruan se nuk i japin Sulltanatit ushtarë për luftën. Por, kur Greqia donte të rrëmbente Maqedoninë e Epirin, domethënë Shqipërinë, simpatitë u kthyen në zemërim, dhe "... u lëshuan të mbrojnë mëmëdheun e tyre". Porta e Lartë, premtoi tituj, shpërblime e privilegje në administrimin e vendit dhe bëri për vete parinë shqiptare si dhe siguroi mobilizimin e forcave "vullnetare" shqiptare, që u hodhën në luftë kundër ushtrisë greke në kufirin jugor të Shqipërisë, në vilajetin e Janinës. Ushtria greke pësoi disfatë të rëndë në frontin e Janinës dhe u shpartallua plotësisht në tri javë. Lufta pati edhe të rënë të shumtë si ushtarë edhe vullnetarë shqiptarë. Pothuaj luftatarët osmanë në shumicën dërmuese ishin ushtarë nizamë, por që ishin shqiptarë dhe që ishin të bindur se mbronin truallin e tyre amëtar. Kështu ishin me qindra ushtarë të mobilizuar cdo vit në të gjithë Labërinë e më gjerë, që mbushnin vaporin "Daut", që nisej nga skelat shqiptare për në kazemat ushtarake të Portës së Lartë dhe që luftonin në 8 milionë km² në tre kontinente. Një ndër djemtë e Fushëbardhës që luftoi dhe u vra trimërisht për Vilajetin e Janinës ishte dhe Resul Beqo Resuli 27 vjeçar, që ra në fushëbetejë më 1897, babai i dy fëmijëve, që ngeli në këngë: "Fushëbardhë t'u rritën djemtë/Të luftojnë për dovlet,/Djalë i vetëm pa vëlla,/Luftove me pashallarë/Resul Beqo djalë i rrallë/Gjakun derdhe për vatanë..". I tillë ishte "fati" shqiptar për 4-5 shekuj para 1912-tës, që jetën jepnin për shërbim të Perandorisë. Fakt është se me ndërhyrjen e Ruisë dhe të Fuqive të tjera të Mëdha, trupat osmane bashkë me repartet vullnetare shqiptare, e ndalën përparimin

e tyre. Më 19 maj u nënshkrua armëpushimi ndërmjet Sulltanatit Osman dhe Greqisë dhe më 4 dhjetor 1897 nënshkroi Traktatin përfundimtar të Pages. Edhe pse doli fitimtare, Perandoria Osmane, sipas marrëveshjes me Shtetet e Mëdha evropiane, e humbi Kretën, e cila u shpall "autonome" dhe "asnjanëse", nën kontrollin e Fuqive të Mëdha. Gjatë kohës së Luftës greko-osmane të vitit 1897, Esat Pashë Janina ishte Komandant i Shtabit të Gruparmatës III, dhe pas fitores së 1897-tës pati një sërë detyrash të larta; më shkurt 1912 Komandant i Divizionit 23 të Janinës, dhe në tetor 1912 komandant i Gruparmatës së Janinës, që e bëri të njohur Esat Pashën në Luftën për Mbrojtjen e Janinës, në kuadrin e Luftës së Parë Ballkanike, e zhvilluar nga 4 Tetor deri 6 Mars 1913; në betejën e Galipolit, Esati komandonte Grupin Lindor. (Pas luftime u emërua Ministër i Marinës dhe që u shua më 1952). Ballkani u nda në dy zona ndikimi: në atë austriake të perëndimit dhe në atë ruse të lindjes, për të ruajtur status quo-ja në Ballkan. Fuqitë e mëdha dhe që kishin interesa në Ballkan thelluan luftën gjeopolitike të zotërimeve, ku dolën në pah edhe lakmitë e Beogradit, Sofjes e të Cetinës, që e shihnin luftën greko-turke si një moment të përshtatshëm për "të zgjidhur" çështjet e tyre. Gjatë dhe pas luftës greko-turke të 1897 shpërtheu me një forcë më të madhe konflikti kishtar serbo-greko-bullgar. Ishte koha kur në plan të parë kishin dalë pretendimet territoriale mbi viset shqiptare të vilajeteve të Janinës, të Manastirit e të Kosovës. Pas luftës greko-Osmane Sulltanati osman, duke u bërë lëshime të reja shteteve ballkanike, emëroi një mitropolit serb në Shkup në vitin 1897, nxori në pranverën e atij viti urdhrin për hapjen e shkollave serbe në vilajetet e Kosovës, të Manastirit e të Selanikut dhe në fillim të vitit 1898 emëroi dy dhespotë bullgarë në Dibër e në Manastir. Lëshimet osmane acaruan edhe më shumë kontradiktat ndërmjet Bullgarisë, Serbisë e Greqisë, që çuan në përlëshje të reja të përgjakshme midis bandave të këtyre shteteve në viset shqiptare e maqedone dhe ashpërsuan gjendjen politike në Shqipëri, shtuan pakënaqësinë e shqiptarëve, territoret e të cilëve rrezikoheshin të aneksoheshin nga shtetet fqinje. Ishte lufta që do të ndillte vetëm luftë, dhunë dhe përsëri gjak të derdhur të rrafshin ballkanik.

Lufta e katërt për Vilajetin e Janinës (1912-1913) - "kur Janinës ju sos fryma!"

Labërit dhe Osmanët u bënë bashkë sërish në mbrojtjes të truallit shqiptar për shqiptarët dhe në mbrojtje të truallit Osman për osmanët. Ata ishin bashkë edhe në Bezhan. Bezhani i poshtëm dhe Bezhani i sipërm u bënë simbol i qëndresës, duke qenë nyja gordiane mbrojtëse e Vilajetit të Janinës. Fshati Bezhan ishte 14 km në Juglindje të Janinës dhe mbrojtja e Janinës dhe vecanërisht mbrojtja e fortifikuar në Bezhan ishte ideuar nga Marshalli gjerman, Von Der Goltz. Në lartësitë e këtyre dy fshatrave që para më shumë se një shekull e gjysëm dhe sigomos në vitet 1912-1913 ishin ngritur dhe përsosur fortifikata të pajisura për armë e artileri të rëndë. Luftohej me seriozitet dhe në Bunillë/Bonillë, ish-fshatin dhe garnizonin ushtarak ku Ali Pashë Tepelena kishte pallatin veror, në Janinë, në vendin ku u ngrit shkolla e parë ushtarake shqiptare

për këmbësori, artileri, kavaleri e xhenio. Rëndësia dhe fuqia e nyjës së Bezhanit pasqyrohet edhe në vargje: "O Bezhan përmbi Janinë,/ jeshe istikam i mirë,/ treq-ind topa një të shtirë,/ bien gjulet në zinxhirë...". Mjaft domethënëse mesazhi përcjellës. Shqiptarët shpesh kuan faqe heroizmi për historinë tonë kombëtare, ku për muaj me radhë me vështirësi të shumta për ushqime, në të ftohtin e dimrit 1912-1913, me shira e breshër u dhanë goditje vdekjeprurëse forcave greke "aq sa shekujt nuk i harrojnë", por rrezultati final është se fituesit shkruhen në histori, qoftë edhe me tradhëti, me dredhi apo me mashtrim. Ushtria greke guxoi t'i riversulej Vilajetit të Janinës, edhe pas humbjeve të shumta në tre luftra të mëparshme: më 1854, më 1878 dhe më 1897, në luftra që i "kishin kallur datën" aq shumë se mazi u kishte ardhur "shpirti në vend", ndërkohë që osmanët kishin shkuar në "pikën e vdekjes" ndërsa shqiptarët ishin angazhuar edhe në luftime me serbët dhe malazezët, por edhe me mbështetjen maksimale të evropianëve. Gjashtë dekada pas luftës së parë për Janinën të vitit 1854, në vitin 1913 luftimet drejtoheshin nga Esat Pashë Janina dhe Vehip bej Janina, vëllezër dhe ushtarakë më në zë të shkallës së vet. Në nyjën e Bezhanit ishte koka dhe boshti i Gruparmatës së III-të osmane ose sikurse thirrej në origjinal "Içinxhi Kollordu"; ajo përbëhej nga: Divizioni i 23 këmbësori i shërbimit të detyruar 7 vjeçar, ku më tepër se gjysma e tij ishte shqiptar; dhe divizioni i rezervistëve (redif-tymen) i gjithë shqiptar, gjithësej rreth 13 mijë vetë, që duke i shtuar njësitë e artilerisë dhe shërbimeve të tjera dhe mbi 4000 luftëtarë vullnetarë shumica nga Labëria. Fakt është se Divizionet autonome me asqerë në rast luftime, ktheheshin në korpuse, si Korpusi 22 në Kozanë, por çdo korpus tjetër osman kompletohej edhe me redifë/rezervistë 426 shqiptarë si dhe mustafëzë/forca territoriale. Gruparmata me 20 mijë vetë komandohej nga vali Esat Pashë Janina, një nga shtatmadhorët më trima dhe më të zotë të ushtrisë osmane, por me origjinë shqiptare. Fortesa e ngritur në Bezhan përbënte jo vetëm nyjën kryesore të mbrojtjes së Janinës, por dhe pritën kryesore të tërë viseve të tjera të Jugut të Shqipërisë; prandaj ushtarët shqiptarë dhe osmanë qëndruan atje me vetëmohim shembullor. Prej 18 tetorit 1912 e deri më 6 mars 1913 Gruparmata e III-të bëri një qëndresë të fuqishme kundër njërive ushtarake mësyese në fillim 3 herë e në vazhdim 4 deri 5 herë më të shumta në raport forcash. Kur fuqia mbrojtëse po binte dhe fuqia mësyese po rritej truparmata u tërhoq në brezin mbrojtës të Bezhanit. Gruparmata bashkë me rezervistët dhe vullnetarët u gjendën përballë një fuqie sulmuese në rritje të kundërshtarëve dhe se mbështetja nga Stambolli mungonte. Në këto kushte njësitë ushtarake mësyese njëjës së Bezhanit iu veshën nga lindja, jugu dhe perëndimi, duke i prerë kështu rifurnizimin nga ato tri anë. Hapur kishte mbetur vetëm një korridor i krahut verior; koloneli shtabmadhor, Halil bej Kolonja, i vendosur në Konicë me një pjesë të armatës osmane të perëndimit të komanduar nga gjeneral Hasan Riza Pashai nga Prishtina. Ky ishte shtegu ku mbaheshin lidhjet me qeverinë e Vlorës dhe merreshin disa thasë me misër, mbledhur me shumë vështirësi në rrethet e Beratit e Vlorës. Ushtarëve në vend të bukës u jepej nga një grusht miell misri. Në kushte kaq të rënda, me kalimin e ditëve, javëve dhe

muajve, madje edhe të orëve, gjendja po bëhej gjithnjë e më e mjerueshme. Gruparmata e mbetur pa pajisjeje e mbështetje po zvogëlohej dita-ditës; mungesa e municioneve të armëve të rënda e të lehta po ndihej përherë e më shumë. Fuqia mbrojtëse u varfërua aq shumë, saqë për mungesë predhash çdo top shtinte vetëm 2-3 herë në ditë. Po kaq e dobët paraqitej dhe gjendja e armëve të lehta. Duke ditur gjendjen e vajtueshme të mbrojtësve të Janinës, princi trashëgimtar dhe komandant i njërive ushtarake greke pranë Janinës, Kostandini, duke mbajtur parasysht edhe se Esad pashë Janina me të ishte bashkëstudiuues në Akademinë Ushtarake Gjermane në Berlin, e ftoi disa herë që të ndërpriste vazhdimin e qëndresës, për mbrojtjen e Vilajetit të Janinës. Por Esat pashë Janina i përgjigjej: "Jo, do luftojmë!". Ndërkaq shtatmadhuria greke duke u mbështetur në çka përbënte Janina për Jugun shqiptar, duke përfutur edhe nga vendi krejt i lirë për të, përballë dy njërive osmane në zvogëlim përqëndroi 6 njësi ushtarake, të reja. Në rre-



thana të tilla njësitë ushtarake mësyese në mëngjesin e datës 6 mars 1913 mundën të çanin një shteg në anën perëndimore të brezit të luftimeve dhe u dyndën brenda njëre mbrojtëse të Bezhanit. Vijimi i mëtejshëm i mbrojtjes do të ishte marrëzi e gjakderdhje e kotë. Esat pashë Janina me miratimin edhe të shumicës së parësisë më të lartë të Shqipërisë së jugut, e cila gjatë 6 muajve që vazhdoi lufta qëndroi përherë në Janinë për mbrojtjen e "Kryeqytetit të Shqipërisë", pranoi ndërprerjen e luftimeve. Hidhërimin dhe tronditjen që shkaktoi shkatërimi i njëre mbrojtëse rreth Bezhanit, ndër atdhetarët e shumtë, i ka pasqyruar edhe njëri prej tyre në vargjet e veta, botuar në fletoren "Zgjimi", Korçë, dt. 15.1.1914: "Ra Bezhani, ra Bezhani! Qaj, moj Shqipëri e mjerë./ Ç'është kjo mynxyrë e madhe./ që të gjeti këtë herë!?!...". Mposhtjen e njëre mbrojtëse të Bezhanit dhe rënien e Janinës e vajtuan edhe osmanët, gjë që dëshmohet nga vargje: "Ç'ka që qan dovletin ynë?/ Qan për çinxi ordhinë./ U batërdis në Janinë./ jo pakë, po njëzet mijë/ burra e trima të mirë./ dhanë xhan, humnë zoinë./ djalëri e levandinë./ me dhëm' e brrijën harbinë./ me gjoks e prisjën sfungjinë". Për mbrojtjen e dy qarqeve të Çamërisë dhe atë të Janinës vetëm gjatë 6 muajve të Luftës Ballkanike dhanë jetën gati gjysma e luftëtarëve të taburëve të Filatit, ku përmblidhej dhe Konispoli me fshatrat pranë, Margëllëçit e Paramithisë, pa folur pastaj për qindra luftëtarë vetëdashës para e pas ushtarakë. Banorët që luftonin për mbrojtjen e shtëpisë së tyre, krahinës jugore e trevave shqiptare

ishte Çamëria, që ka marrë emrin nga lumi Tiamis, qysh në kohën ilirike, që sot quhet Kalama. Treva është me thellësi historike si fisi ilir i Thesprotëve, me rreth 2400 km katror më 1912 dhe me rreth 50 mijë banorë. Në gjashtë dekada janë rreth 6000 të rënë në gjithë Vilajetin e Janinës, edhe pse historia e historianët nuk kanë mundur t'i dokumentojnë plotësisht. Në luftën e katërt të Janinës më 1912-1913, "kur Janinës ju sos fryma" ranë trima të Labërisë si luftëtarët e Ramicës së Vlorës: Kalo Velo Boraj, Taulla Tartar Veshaj, Myftar Musa Canaj dhe Banush Ali Xhihaj; nga fshati Fushëbardha nga 40 luftëtarë vullnetarë e redifë (rezervistë) që morën pjesë në luftime ranë në fushën e nderit Rustem Shalari, Muho Cama, Resul Peçi, Islam Zyber Kondi, Ismail Nora dhe qindra luftëtarë nga të gjithë trevat jugore të Shqipërisë.

Fundi i osmanëve në Janinë dhe humbja e trojeve shqiptare

(Të rënë në Bezhan, Grebene dhe frontet e tjerë të luftës më 1913)

Ndër të rënë në Bezhan ishin Ali Beqir Kurballi, Haxhi Ali Ademi, Ilmaz Isa Shana, Sadik Husejn Sallata, Subhi Hamit Gjuzeli, nga Margëllëçi, Hasan Ali Hania, Refat Mehmet Buza nga Luarati, Mamo Harun Haxhiu, Nelo Himo Kuçuku nga Karbunari, Abedin Osmani nga Salica, Malko Meti nga Pjadhuli, Muharrem Lami nga Kurtesi, Osman Taipi nga Mazrrekët, Sheme Rushani nga Konispoli e Xhemali Mustafa Xhemo Zeqiri nga Karbunari. Luftëtarë që ranë pesë Puse, Islam Bahri Nuhu nga Dolani, Met Mustafa Kasim Koceni nga Picari, Nuredin Budo Brahimi nga Grikëhori, Serjan Sako Omeri nga Gardhiqi e Zejnel Qemal Haxhiu nga Karbunari. Rënë në Shkllivan: Jakup Nexhipi nga Varfani. Rënë në Këmshadhë: Malo Ganiu nga Salica e Sherif Malkua nga Dhrimica. Rënë në Anua: Zan Abedini nga Vreshtazi. Rënë në pesë Lëmenjtë/Sharkovicë: Çafa Sulejman Feçi nga Filati, në Shkallë të Qeramicës: Meçe Karroqi nga Filati e Halil Buxhua nga Janjari. Nga Fushëbardha e krahinës së Kardhiqit ranë Rustem Shalari dhe Muho Cama më 1913 në Grebene, ndërsa Resul Peçi, Islam Kondi, Ismail Nora që kanë rënë më 1913 në fortesat e Bezhanit rreth 14 km përpara Janinës. Në Bezhan kishin rënë përpara gjashtë dekadash më 1854 dy djem të Fushëbardhës Bajo Kazo dhe Habib Xhuvani që njihen të dokumentuar si të rënë e parë të njohur zyrtarisht të rënë në fushëbetejë në mbrojtje të trojeve shqiptare të Vilajetit të Janinës. Emra të shumtë të të rënëve gjatë luftimeve në Bezhan, Pesë Puse, Anua etj., gjenden në librin "Çamëria dhe Janina në vitet 1912-1922". Humbjet shqiptare në Bezhan kanë qënë rrëqethëse nga pala shqiptare e osmane; por edhe më të lemeritshme kanë qënë ato të grekërve. Të rënë në mbrojtje të Vilajetit të Janinës janë nga të gjitha krahinat shqiptare, por më të shumtë kanë qënë nga Labëria e deri nga Mirëdita. Fakt është se kanë qënë me mijëra, por mungojnë listat emërore të përpikta të kohës. Në betejën për trojet shqiptare në luftën për Vilajetin e Janinës pati edhe shumë të plagosur në të gjitha frontet e luftës, në Bezhan, në Grebene, në Paramithisë, në malin Kurilë. Por Bezhani kishte qënë nyja kryesore që kishte penguar rënien e

Janinës, por kur kjo nyjë u asgjësua, nuk mbetej më kurrfarë mundësie për të shpëtuar jo vetëm Janinën nga pushtimi prej njërive ushtarake mësyese greke, por u hap për to edhe udha për pushtimin e trojeve të tjera shqiptare. Rënia e Janinës për Shqipërinë ngjasonte me një ndër gjëmën. Pas rënies së Bezhanit, njësitë ushtarake mësyese greke pushtuan Janinën dhe nuk u ndalën por menjëherë vunë në përdorim thikën e plumbin dhe vazhduan vërshimin drejt afërsisë së Vlorës, Beratit e Elbasanit. Princi trashëgimtar, Kostandini, duke shkëlur marrëveshjen e sapo nënshkruar me gjeneral Esat Pashë Janinën mbi kushtet e dorëzimit, me pamëshirshmërinë gjithë të dorëzuarit e të sëmurët si dhe të plagosurit i dërgoi në Epahto, i mbyllën në kala pa mjekim ku mijëra prej tyre vdiqën të uritur, prej morrit dhe sëmundjeve të ndryshme. Të vdekurit ishin aq të shumë, sa që kufomat e tyre i hidhnin në gropa të përbashkëta. Ky nuk ishte fundi pa lavdi i Sulltanatit osman që sundonte prej pesë shekujsh, por një dëm i pallogaritshëm i humbjes së territoreve të truallit shqiptar, të pushtuar dhe sërish të ripushtuar nga ethet e nacionalizmit me orekse të shtuara.

Trojet që “humbën” me diplomaci dhe tradhëti

Historia e marrëveshjes për Janinën! Vilajeti sa një “makinë me portokalle”!

Fillim marsi i 1913-ës, po u buzëqeshte fqinjëve. Po përgatitej marrëveshja për dorëzimin e Janinës, që rezistuan deri më 6 mars 1913. Lajmi ishte tragjik. Më 7 mars 1913 armata e Kostandinit (që kishte në total 113 mijë vetë, 4 divizione këmbësorie, forcat speciale “Evzon” me 7 batalione e artileri), hyri në Janinë, ku mbrojtësit e Esat Pashë Janinës më në fund u dorëzuan 550 oficerë, 22 mijë ushtarë e nënoficerë, nga të cilët 12 mijë osmanë e 10 mijë shqiptarë. Humbjet ishin 4000 shehitë/dëshmorë dhe të humbur, 7000 të plagosur e të sëmurë në spitale; 22 mijë robër përfshi dhe 4 gjeneralë/pashallarë; 6000 prej robërve u kapën të plagosur e të sëmurë në spitale. Vetëm 5000 vetë ikën drejt veriut dhe u bashkuan me pjestarët e Armatës që mbroheshin në Konicë, Leskovik e Kolonjë. Me të ikurit ishte dhe gjenerali kosovar Ali Riza Pashai. Princ Kostandini nuk deshi të vinte dorë, sic ishte zakoni në rastet e fitores mbi shtatën e gjeneral Esat pashë Janinës, duke thënë: “Shpata e heronjve nuk merret!”. “Rënia e Janinës” shkaktoi dhimbje e gjëmë në trojet shqiptare, që u shpreh në mjaft publimime. Edhe sot flitet e shkruhet për historinë e rënies së Janinës, që është nyja gordiane për mbrojtjen e Çamërisë, por është edhe fronti ku u derdh shumë gjak për Vilajetin-kryeqendër të Jugut të Shqipërisë. Hidhërimi dhe brenga shfaqet edhe në vargje: “Janinë, të humbi nami, /t’u ul në vatër Juani./ Janinë, të zuri dhrimi,/kur të shkeli qafiri,/evzonet dhe Kostandini.” Në kohën e dorëzimit të qytetit të Janinës në mars 1913 përbëhej nga këto lagje: Dederuç, Pazari i Drithërave, Guraba, Ibrahim Pasha, Kalluça, Karavatja, Luca, Mitropolia, Namazgjah, Shën Gjergji, Mejdan etj. Rreth “rënies së Janinës” dhe dorëzimit të saj prej më shumë se një shekulli, qëndrojnë në këmbë edhe padia për Esat pashë Janinën, ndërkohë që analizat historike thonë se Kostandini, me anë të armëve nuk mundi të

bënte më tepër se komandanti para tij, Sapunxhaqi, dhe si bir mbreti që ishte, zgjidhi grykën e thesarit shtetëror. Sipas “marrëveshjes së fshehtë”, të pavërtetuar midis Kostandinit dhe Esad pashë Janinës, në Janinë u fut një makinë ngarkuar me “portokalle”, që u lejua të kalonte pa u kontrolluar në brezin e mbrojtjes. Portokalleve “u ishin hequr thelpinjtë dhe në vend të tyre ishin mbushur me florinj, pastaj ishin mbyllur me shumë mjeshtëri”. Pas dy ditësh mbrojtësit u urdhëruan t’u dorzoheshin njërive ushtarake të Armatës së Epirit. (Gazeta “Liri e Shqipërisë”, Sofia, datë 23.2.(8.3) 1913). Padia për Esat pashë Janinën për bukshkelës ndaj atdheut dhe pabesi ndaj bashkëluftëtarëve për “shitjen e Janinës” nuk është vërtetuar as nga “gjqyqi i Stambollit”. Një dëshmi e Musa Hamit Demi-t, i cili ka qenë dhe i burgosur prej tij, dëshmonte: “Në përbërjen e Komisionit Qeveritar që u dërgua nga Vlora në Janinë isha dhe unë. Pamë gjendjen në qytet, spitalet ushtarake dhe civile, qëndresën në brezin e mbrojtjes në tërë gjatësinë e tij, mungesat në ndihma, ushqime, armatime; në vend të bukës ushtarët hanin miell misri...”. Ka gjithashtu burime gojore, përsëkrime historianësh e vëzhguesish



të huaj, të paanshëm, që treguan trimërinë e rrallë, vendosmërinë luftarake për përballimin e armatës . Për shfaqësimin e Esat Pashë Janinës shërben edhe “vendimi” i gjyqit ushtarak të Stambollit, që pas Luftës Ballkanike kaloi në sitë cilido komandant njësie osmane të mundur në atë luftë apo të dorzuar tek kundërshtari. Esat Pashë Janina jo vetëm u konsiderua “i pafajshëm”, që luftoi “dhëmb për dhëmbë”, me “shpirt në dhëmbë”, por ai u caktua komandant i njërive ushtarake që mbronin ngushticën e Dardaneleve dhe krejt gadishullit të Galipolit; ku edhe marrshalli Mustafa Qemal Pasha, ishte në vartësi të tij. Fakt është se Esad pashë Janina pati guximin të qëndronte rob me bashkëluftëtarët e tij dhe nuk e përjashtoi veten nga pasojat e humbjes së luftës, pavarësisht se fitimtari ishte shoku i tij i klasës.

Rënia e “Kapital of Albania” ose “Kryeqyteti i Toskërisë”

Lebërit në muret e fortesës së Bezhanit, vetëm pak kilometra larg Janinës nuk i mundën plumbat e predhat, nuk i prenë jataganët, por tradhëtia e drejtuesve të lartë ushtarakë. Fakt është se Valiu dhe komandanti i Janinës Esat Pashë Janina në vitet 1891-1893, së bashku me grekun Kostandin kishin studiuar në Berlin në Akademinë e Shtatmadhorisë Gjermane, pa e parashikuar se pas

dy dekadash do të gjendeshin përballë njeri-tjetrit. Një histori enigmë janë "dhurata e portokalleve" të dërguara në Janinë nga Grekët?! Në planin diplomatik vetëm qeveria austro-hungareze pranë Konferencës së Ambasadorëve ngulte këmbë fuqishëm që Janina dhe Shkodra të mos shkëputeshin nga tërësia tokësore shqiptare, dhe t'i ngeleshin shtetit shqiptar. MPJ i Austro-hungarisë Berchtoldi që në takimin e parë me Ismail Qemalin, sapo ai arriti në Vjenë gjatë udhëtimit për në Shqipëri, i tha "Qeveria jonë do që Shqipëria të dalë më vete si një shtet i bashkuar që të përmbledhë brenda tij gjithë shqiptarët dhe të jetë në një shkallë me popujt e tjerë ballkanikë". Edhe pas pyetjes së Ismail Qemalit se: "Flamurin kuq e zi e kam por nuk kam ku ta naltoj", mori përgjigjen diplomatiko-ushtarake: "Naltoje në një bajonetë austro-hungareze" ishte sinjifikative. Por antishqiptarët ishin shumicë në Konferencën e Londrës, që donin që shtrirjen gjeografike të shtetit të ri shqiptar ta "lidhnin", si padashje me rënien e Janinës në terren. Në mars 1913 në Janinë gjendeshin në front rreth 12 mijë luftëtarë shqiptarë, të pamjaftueshëm në raport forcash; ndërkohë që rruga detare Anadoll-Shqipëri, e vetmja e kohës prej nga mund të dërgoheshin njësi ushtarake, armatime e pajisje si edhe ndihma të domosdoshme, ishte mbyllur plotësisht prej luftëtanijeve të saj që nga fillimi i luftës. Duke shfrytëzuar avantazhet e rrethanat përparësi kryesore dhe nxituar nga synimet grabitqare për viset jugore, ushtria përditë me më kokëfortësi ngulmonte në përmbushjen e qëllimeve. Në këto rrethana drejt Janinës kishin vërshuar masivisht forca greke me qëllim që para nënshkrimit në Konferencën e Londrës "Janina të ishte jashtë hapësirës administrative shqiptare", sikurse ndodhi në të vërtetë. Xhephanja e luftës në Bezhan dhe nyjeve të tjera të brezit mbrojtës në të dyja anët e frontit bënë që ushtarët grekë të ropateshin tre muaj me radhë përballë fortesave që përballë kishin një grusht lebërisht që mbronin vendin e stërgjyshërve me nder e me trimëri. Luftime të ashpra vijonin edhe në Zagorë e Mecovë dhe në çdo front tjetër, por të gjitha luftimet kishin Janinën, "Kapital of Albania", sic cilësohej në enciklopeditë e vendeve të huaja ose "Kryeqyteti i Toskërisë", që ishte nyja gordiane e Jugut Shqiptar. Prandaj edhe atdhetaret shqiptarë ishin duke bere cdo perpjekje te mundshme qe ate te mos ua rrembenin. Pushimi i përkohshëm i luftimeve s'ishte gjë tjetër, veç një iluzion për t'u rindezur përsëri. Ankthin e atdhetarëve për humbjen e Janinës e shpreh vargu popullor: "Janinë, të hiftë zjarri,/raftë e të mbuloftë mali,/t'erdhi te dera Junani!/Janinë, çerek Stambolli,/daltë e të mbyttë gjoli,/hapi sytë, se të mori!". Ndërkohë që edhe pëfaqësuesi i qeverisë austro-hungareze në Janinë, Bilinski, kerkonte vazhdimisht dhe ndihmen e qeverisë së përkohshme shqiptare të Vlorës dhe të atdhetarëve të tjerë të vendit. Bilinski në shkresën e datës 10.12.1912 dërguar përfaqësuesit të qeverisë së Vlorës: "Shqiptarët e sanxhaqeve/qarqeve të Janinës, Gjirokastrës e të Reshadijes mbajtën një mbledhje dhe vendosën të dërgojnë pa vonesë në Vlorë Musa Hamit Demin nga Filati, për të kërkuar nga Ismail Qemal Bej Vlora qëndrim energjik kundër pushtuesve grekë". Frontrashëgimtari i mbretërisë greke, princ Kostandini fuqizoi mësymjen me "fuqi të mjaftueshme" për "Armatën e Ipirit", përballë mbrojtësve të Janinës që vuanin tmerrësisht përballë një force mësymëse të dy divizioneve

ushtarake me rreth 60 mijë ushtarakë të armatosur, që më 24.1.1913 kishin përballë rreth 20 mijë ushtarakë kryesisht shqiptarë dhe turq, të mbështetur nga 109 topa të vjetër të vendosur kryesisht në Bezhan, ose tek "Fortesa e Janinës". Edhe me shkuarjen në front të një pjese të Armatës së Perëndimit, numri i mbrojtësve shkoj në 26 mijë vetë, por 5000 vetë ishin të plagosur e të sëmurë, që dergjeshin spitaleve të atjeshme. Sipas dokumentave të botuara nga Lef Nosi, për gjysmën e dhjetorit 1912, kohë kur në Janinë arriti gjeneral Ali Riza Pasha me një pjesë të luftëtarëve të ngelur të "Armatës së Perëndimit". Qeveria e përkohshme e Vlorës e Ismail Qemalit dërgoi në Janinë Mitat Frashërin me një përfaqësi, që arriti në Janinë më 13.1.1913 për masat për të shtuar fuqinë mbrojtëse në Janinë dhe në fakt në mbrojtje të saj shkuan edhe dy tabure/batalione: taburi i Gjirokastrës dhe taburi i Tepelenës. Ndihma konkrete e Ismail Qemalit vetëm sa i dha frymë dhe shtyu në kohë rënien e Vilajetit por nuk mundi ta pengonte dot, jo vetëm për luftën totale në terren krejtësisht të pabarabartë, por edhe për veprimin diplomatik në Londër që ishte kundër shqiptarëve në jug të Shqipërisë natyrale. Shkrimi u kushtohet luftëtarëve fushëbardhas që ranë në fushën e nderit në tri epoka: Bajo Kazo, Habib Xhuvani (1854), Abedin Muho, Seit Dobra, Shahin Mema, Hair Stefani, Idriz Alidhima, Sali Isufi, Xhafer Gjoni, Osman Deçka, Shahin Veliu, Mato Asllani; Sadik Memushi, Skëndo Xhuvani, Myrteza Sulli, Musa Rafi (Robi), Hito Kongoci (1878), Resul Beqo Resuli (1897), Rustem Shalari, Muho Cama, Resul Peçi, Islam Kondi, Ismail Nora (1913) në Bezhan, Pesë Puset, Mecovë, Grebene, etj., në Vilajetin e Janinës, në betejat për truallin shqiptar.

Bibliografi:

- "Historia e Popullit Shqiptar", Instituti i Historisë (Akademia e Shkencave), Vëll III, IV, Tiranë, 2008.
- Eqërem Bej Vlora, "Kujtime 1885-1925", përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: IDK, 2003.
- "Historia e Popullit Shqiptar", Kristo Frashëri, Kristaq Prifti, Vëllimi II, Tiranë: Toena, 2002.
- Evlia Çelebi, "Shqipëria 350 vjet më parë", Horizont, Tiranë 2000.
- Mexhit Kokalari, "Trima të kryengritjeve popullore", Tiranë, SHB "8 Nëntori", 1979.
- Ibrahim D. Hoxha, "Camëria dhe Janina në vitet 1912-1922", Tiranë, 1996.
- Ferhat Golemi, "Nga Fushëbardha në Ushtrinë Popullore", Tiranë, GentGrafik, 2015.
- Përparim Çarçani, "Çarçanët e Fushëbardhës-Gjenalogjia e fisit Çarçani", Tiranë 2011.
- Ibrahim Pajova, Shahin Leka, "Historia e Artit Ushtarak Botëror", Kapitulli: Lufta italo-greke, Tiranë, 1987, fq. 288-330.
- Immanueli, "Lufta Ballkanike", 1912-1913, Rrethimi i Janinës dhe i Shkodrës.
- Rami Memushaj, "Histori e Kurveleshit", Botimet Toena, Tiranë, 2004.
- Fondet Arkivore të Institutit të Historisë, Dosja: A-IV.107.fq.45.
- Timo Dilo, "Shënime historike rreth shpalljes së pavarësisë dhe viteve të para të shtetit shqiptarë".
- Gazeta "Liri e Shqipërisë", Sofia, datë 23.2.(8.3) 1913.
- Periodiku i gazetave "Ushtria", Revistës "Mbrojtja", "Për Mbrojtjen e Atdheut", "Revista ushtarake" etj.
- Basil Kondis, "Greece and Albania 1908-1914".
- Hristo Meksi, "Kryengritja greke dhe luftetaret që morën pjesë".
- Ibrahim D. Hoxha "Enciklopedia Jugshqiptare", Tiranë, fq. 221.
- Gazeta "Ora" nr. 5, dt. 1.1.1929, fq. 4-5.
- François Pouqueville "Histoire de la regeneration de la Grece 1740-1824", vol. 3 fq. 131-134.
- "Viset kombëtare Shqiptare ne shtetin Grek", fq 211, 416.
- Syrja Vlora, Kujtime, "Nga fundi sundimit Osman në Luftën e Vlorës", Tiranë: "ICEBERG" Publishing House, 2013.
- Fletorja "Kosova" nr. 14 (68) Tiranë, gusht 1944, fq. 3.
- Sejfi Vilamasi, "Ballafaqime politike në Shqipëri", 1897-1942, Tiranë: 1995.
- Fondet Arkivore, Instituti Historisë A.IV.107.
- Fletorja "Dielli", Boston,USA, datë 24.10.1912.
- Hamdi Ertuna, Yanya savunmasi ve Esat Paşa, Kültür ve Turizm Bakanlığı, 1984, 97. & Sermet Atacanli, Atatürk ve Çanakkale'nin komutanları, MB Yayınevi, 2006.



Misioni i NATO-s “Sea Guardian”

NISET KONTIGJENTI XIV DREJT DETIT EGJE



Kontingjenti përbëhet nga 21 ushtarakë, mes të cilëve edhe 2 vajza. Ai komandohet nga kapiteni i rangut III Albion Bitraj.

